

2021

Raport Vjetor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM



Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

*Ky raport përmbledh veprimtarinë e kryer nga institucioni gjatë vitit 2021.

PËRMBAJTJA


HYRJE	4
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	7
01 ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË	9
01.1 NDËRGJEGJËSIMI	9
01.2 RRRITJE KAPACITETESH	11
01.3 KOMUNIKIMI STRATEGJIK	17
01.4 BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR/ RAJONAL/ NDËRKOMBËTAR	19
02 ZBATIM TË PLANIT TË RI-INTEGRRIMIT	36
PROGRAMI NR. 1 – NDËRHYRJA NË BASHKINË ÇËRRIK	36
PROGRAMI NR. 2	39
03 MONITORIMI DHE RAPORTIMI	45
04 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV	48
05 PRIORITETE 2022	49

QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM	QKEDH
PARANDALIMI DHE KUNDËRSHTIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM	P/KEDH
STRATEGJIA KOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM	STRATEGJIA KOMBËTARE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE	MSHMS
MINISTRIA E BRENDSHME	MB
MINISTRIA E MBROJTJES	MM
MINISTRIA E DREJTËSISË	MD
MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË	MFE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	MAS
ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE PËR MIGRACIONIN	IOM
ANGAZHIMI I KOMUNITETIT GLOBAL DHE FONDI I QËNDRUESHMËRISË	GCERF
KOMISIONI EVROPIAN	KE
REHABILITIMI DHE RI- INTEGRIMI	R&R
INSTITUTI PËR AKTIVIZËM DHE NDRYSHIM SOCIAL	IANS
AGJENCIA E MBËSHTETJES SË VETËQEVERISJES VENDORE	AMVV
VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE	VKM
QENDRA PRITËSE E TRAJTIMIT TË RASTEVE TË RIKTHYER NGA SIRIA DHE IRAKU	QENDRA PRITËSE
LUFTËTARË TË HUAJ TERRORISTË	LHT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE	DPB
AUTORITETIN KOMBËTAR PËR CERTIFIKIM ELEKTRONIK	AKCESK
QENDRA PËR STUDIMIN E DEMOKRACISË DHE QEVERISJES	CSDG
QENDRA PËR NISMA LIGJORE E QYTETARE	QNLQ

Hyrje

Përgjatë vitit 2021, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (në vijim QKEDH) ka vijuar realizimin e misionit të saj koordinues ndër-institucional në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm duke zbatuar Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin Kombëtar të Veprimit (P/KEDH) si dhe zbatimin e Planit të Ri-integrimit të të riatdhesuarve gjatë tri proceseve të kryera për riatdhesimin e shtetasve të mbetur në kampet e ish vendeve të konfliktit Siri dhe Irak.

Aktiviteti është fokusuar në zbatimin e veprimtarisë së planifikuar në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me partnerë/aktorë të ndryshëm të shoqërisë për përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit (P/KEDH) në parandalimin e fenomenit, të procesit të Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit (RRR) në komunitet të 24 (njëzetë e katër) shtetasve të riatdhesuar nga vendet e konfliktit Siri dhe Irak, pesë prej tyre të riatdhesuar më 27.10.2020 dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetas të riatdhesuar më 1 Gusht 2021.





QKEDH ka nxitur përmes koordinimit dhe bashkëpunimit me ministrinë e linjës dhe institucione të tjera që implementojnë masa kundër ekstremizmit të dhunshëm, procesin e hartimit të Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit 2022-2026, ndërsa ka vijuar me zhvillimin e Objektivit të II-të të Strategjisë aktuale Kombëtare, Komunikimi Strategjik, përmes disa iniciativave institucionale si edhe nëpërmjet ndërhyrjeve të tjera të nxitura dhe të koordinuara me partnerët mbështetës të institucionit QKEDH.

QKEDH ka promovuar dhe mbështetur rolin e shoqërisë civile në zbatimin e plotë të veprimit të P/KEDH-së në koordinim me institucionet e linjës. Ka kontribuar me ide – propozimet e kërkuara në kuadër të zbatimit të P/KEDH me qëllim tërheqjen e granteve¹ të vogla të publikuara nga donatorët mbështetës të Qeverisë Shqiptare në fushën e P/KEDH në mbështetjen dhe promovimin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) shqiptare në kuadër të idesë së partnershipit publik-privat për forcimin e rolit të tyre, si dhe në marrjen e fondeve të akorduara nga organizata ndërkombëtare Angazhimi i Komunitetit Global dhe Fondi i Qëndrueshmërisë (GCERF) me qëllim kontributin dhe impenjimin e OSHC-ve në përfitimin e fondeve të konsiderueshme ndërkombëtare në kuadër të zbatimit të P/KEDH në Shqipëri.



¹Referuar Organizatave të Shoqërisë Civile lidhur me grantet e akorduara nga Ambasada e SHBA-ve

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

QKEDH ka realizuar veprimtarinë e planifikuar për të përmbushur objektivat e Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me fokus të veçantë në procesin e ri-integrimit dhe rikthimit në komunitet të 24 (njëzetë e katër) shtetasve të riatdhesuar nga vendet Siri dhe Irak, si dhe procesin e hartimit të Strategjisë së re Kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe Plani i Veprimit 2022-2026.

Në kuadër të zhvillimit të **Komunikimit Strategjik** si një prej tre objektivave sfidues të P/KEDH, u finalizua studimi² “Eksplorimi i zhvillimit të një komunikimi strategjik në P/ KEDH në Shqipëri - Qasje e bazuar në kërkim” pas bashkëpunimit më shumë sesa një vjeçar me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), ndërsa janë realizuar 12 (dymbëdhjetë) dalje publike të QKEDH-së në mediat televizive vendase dhe të huaja. Drejtori i QKEDH-së, znj. Lejdi Dervishi ka dhënë 4 (katër) intervista³ me fokus aktivitetin e institucionit.

²Ky raport është përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me mbështetjen e Hedayah, Qendrës Ndërkombëtare të Ekselencës për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, financuar nga BE.

³Shih pikën 4.3 Komunikimi Strategjik.

Gjatë vitit 2022, në faqen zyrtare të **MASR⁴-së u hap rubrika** dedikuar rrjetit të mësuesve koordinatorë kundër ekstremizmit të dhunshëm e cila kontribuon në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në sektorin e arsimit.

Në funksion të zhvillimit të këtij objekti, QKEDH ka marrë pjesë dhe realizuar 81 (tetëdhjetë e një) takime informuese/ veprimtari trajnuese/ webinarë online, 10 (dhjetë) video-konferenca, si dhe ka nënshkruar 4 (katër) marrëveshje bashkëpunimi me partnerë implementues në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga P/KEDH, ndërsa janë në proces për finalizim në vitin 2022, draft-marrëveshja e bashkëpunimit midis institucionit tonë dhe Rektoratit të Universitetit të Tiranës, si dhe draft-marrëveshja me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bashkëpunimi me partnerët në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar ka vazhduar të jetë cilësor dhe vizionar. Një bashkëpunim i tillë ka nxitur zbatimin e Planit të Veprimit, si dhe Planin e Ri-integrimit të ndërmarrë nga QKEDH duke e çuar përpara agjendën e Qeverisë Shqiptare në zbatimin e tyre. QKEDH ka marrë pjesë dhe koordinuar në 39 (tridhjetë e nëntë) konferenca dhe 104 (njëqind e katër) takime (online/onsite).

Në muajin shkurt 2021 u vendos në dispozicion për qytetarët një numër⁵ telefoni ku mund të raportohen ngjarje që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm.

QKEDH nisi në muajin korrik 2021 procesin e hartimit të Strategjisë së re Kombëtare për luftën kundër fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe Planin e Veprimit 2022-2026.

Procesi ka mbledhur në 13 (trembëdhjetë) tryeza pune përfaqësues të partnerit Terres des Hommes (TdH) i kontraktuar nga QKEDH për asistencë gjatë procesit hartues, të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera që implementojnë masa kundër ekstremizmit të dhunshëm.

QKEDH është i vetmi institucion publik me funksion koordinues në parandalimin e fenomenit dhe në zbatimin e dy proceseve⁶ ri-integruese që mbështeten nga BE, SHBA dhe Qeveria Holandeze. Në kuadrin e implementimit të Procesit të Ri-integrimit për të riatdhesuarit shënjohe bashkëpunimi i QKEDH-së me partnerin strategjik GCERF i cili mbështet financiarisht OSHC⁷ që punojnë në fushën e P/KEDH. Më 17 maj 2021 u firmos dhënia e granteve për këto organizata nga ky partner strategjik i QKEDH.

⁴<https://arsimi.gov.al/parandalimi-i-ekstremizmit-ne-arsim/>.

⁵Linja Telefonike Kombëtare për Ekstremizmin e Dhunshëm 0800 45 45.

⁶QKEDH ka ndërmarrë dy programe Rehabilitimi dhe Ri-integrimi (R&R) për personat që vijnë nga vendet e ish konfliktit, Siri dhe Irak, si dhe për familjet e tyre. Projekti I-rë u zhvillua në bashkinë Cërrik që nga maji i vitit 2020 dhe përfundoi në Tetor të vitit 2021. Projekti II-të është rehabilitimi, ri-integrimi dhe ri-socializimi i 24 shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga ish vendet e konfliktit, pesë prej të cilëve u riatdhesuan në tetor 2020, 19 shtetas të tjerë në muajin Gusht 2021, ndërsa priten të riatdhesohen shtetas të tjerë të mbetur në kampet e ish vendeve të konfliktit.


⁷Më 17 maj 2021 u firmos dhënia e granteve për OSHC-të që veprojnë në fushën e P/KEDH në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni në mbështetje të rehabilitimit dhe ri-integrimit të ish luftëtarëve të huaj dhe familjeve të kthyer nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.

Në kuadër të raportimit institucional, Qendra QKEDH ka realizuar 122 (njëqind e njëzetë e dy) raportime periodike pranë strukturave të përcaktuara në kuadër të P/KEDH si edhe 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) raportime mbi zhvillimin e procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit e 24 (njëzetë e katër shtetasve) të riatdhesuar nga vendet e ish konfliktit.

1. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm⁸, QKEDH ka vijuar të zbatojë Planin e Veprimit të kësaj Strategjie i cili referon aktivitete që kryhen me ministrinë e linjës në bashkëpunimin me institucionet shtetërore në nivel qendror, vendor dhe me institucione jopublike, në partneritetet e ngritura me organizatat ndërkombëtare për procesin e Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit në komunitet, në bashkëpunimin me OSHC-të, me palët e treta, si dhe me rrjetet e ngritura pranë Qendrës⁹.

1.1 NDËRGJEGJËSIMI



⁸Strategjia Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 930, datë 18.11.2015 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit"

⁹Pranë QKEDH-së janë ngritur rrjeti i komuniteteve fetare, rrjeti i medias, ndërsa janë në proces krijimi disa rrjeteve të tjera.

QKEDH ka kryer takime informuese me një pjesëmarrje prej 354 (treqind e pesëdhjetë e katër) të pranishëm; ka zhvilluar takime me palë të treta, mbulime mediatike, ndërsa ka vazhduar puna për vizibilitetin e aktivitetit të institucionit duke kryer rregullisht publikimin e këtij aktiviteti në faqen zyrtare WEB, rrjetin social Twiter dhe në Linked-in.

Në kuadër të bashkëpunimit më Rektoratet e Universiteteve në vend, QKEDH dhe Instituti i Studimeve Ndërkombëtare ka organizuar dy forume informues-ndërgjegjësues me studentët dhe pedagogët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) dhe Fan S. Noli, Korçë, në kuadër të projektit “Universitetet - Fronti i ri i angazhimit QKEDH”. QKEDH ka zyrtarizuar marrëveshjen¹⁰ e bashkëpunimit me UAMD, ndërsa vijon të jetë në proces nënshkrimi i Marrëveshjes¹¹ së Bashkëpunimit (MOU) mes QKEDH-së, MAS dhe Rekorateve të Universiteteve në nivel kombëtar me fokus ndërhyrjen disa përmasore për parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit në këtë sektor të edukimit.

Aktivitet i rëndësishëm është zhvilluar edhe në sektorin e drejtësisë. QKEDH u bë pjesë e tryezës online të diskutimit për prezantimin e protokollit ‘Mekanizmi i Sistemit të Referimit për Gratë dhe Vajzat në Konflikt me Ligjin’¹², e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve (DPB), në bashkëpunim me Organizatën ‘Nisma ARSIS’. Dokumenti lehtëson procesin e ri-integrimit të grave dhe vajzave në konflikt me ligjin në Shqipëri. Po në bashkëpunimin me DPB-në, QKEDH përmes partnerit implementues Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social (IANS) organizuan forumin¹³ ndër-institucional një-ditor me fokus aspektet e rehabilitimit dhe të ri-integrimit mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm të të burgosurve.

¹⁰Drejtori i QKEDH-së, znj Lejdi Dervishi dhe Rektori i UAMD, znj Kseanela Sotirofski firmosën më datën 02.12.2021 marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve me qëllim ndërgjegjësimi mbi format e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; njohja, hulumtimi dhe promovimi tek studentët i vlerave të tolerancës, paqes dhe bashkëjetesës së komuniteteve me diversitet kulturor, etnik, fetar Ceremonia e zyrtarizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Rektoratin e UAMD u organizua nga QKEDH pranë ambienteve të saj.

¹¹Procesi ka nisur në tetor të 2020. Pranë MAS-it është përcjellë drafti i parë i MOU-së.

¹²Dokumenti do të standardizojë edhe praktikat procedurale institucionale të ndjekjes dhe ri-integrimit të grave dhe vajzave të cilat janë pjesë e sistemit të burgjeve, si dhe fëmijëve të tyre. Hartimi i këtij protokollit dhe ky takim u mbështet nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) dhe financohet nga BE në Shqipëri.

¹³Aktiviteti u zhvillua me mbështetjen e BE/KE përmes programit “Horizontal Facility for the Western balkans and Turkey 2012-2022”.

Me të njëjtën qasje bashkëpunimi, QKEDH ka marrë pjesë në disa aktivitete ndërgjegjësuere të realizuara nga OSHC¹⁴ që kanë në fokus çështjen e P/KEDH-së. OSHC të ndryshme në vend janë mbështetur nga SHBA-të për të ndërmarrë aktivitete të tilla në komunitetet ku ato punojnë.

QKEDH ka zhvilluar tryeza pune me të rinj dhe gra në kuadër të projektit “Një qasje e integruar për të promovuar gratë dhe të rinjtë paqe-ndërtues në Shqipëri”, i zbatuar nga Qendra e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë (WCDCA), si dhe ka marrë pjesë në takimet e organizuara nga WCDCA për krijimin e këshillave¹⁵ të grave me aktorë lokal dhe të Shoqërisë Civile në kuadër të programit “Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”.


1.2 RRITJE KAPACITETESH

Rritja e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë, të punonjësve të institucioneve të ndryshme dhe të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile, e bashkëshoqëruar me procesin e ndërgjegjësimit në realizimin e P/KEDH dhe zbatimin e programeve të ri-integrimit, ka qenë prioritetet i aktivitetit të institucionit tonë.

QKEDH ka realizuar nënshkrimin marrëveshjeve bashkëpunimi; hartimin dhe publikimin e materialeve mbi aktivitetin e QKEDH-së; ka marrë pjesë dhe realizuar trajnime të iniciuara prej saj apo në bashkëpunim edhe me mbështetje të partnerëve të saj ku kanë marrë pjesë 2214 (dy mijë e dyqind e katërbëdhjetë) punonjës të fushave të ndryshme dhe aktorë të tjerë të përfshirë në këtë proces; ka marrë pjesë në konferenca/ videokonferenca apo bashkëpunime të tjera rëndësishme që adresojnë rritjen e kapaciteteve të këtyre aktorëve.

¹⁴Qendra e Bashkëpunimit Ndër Fetar Elbasan dhe Qendra e Grave për Zhvillim dhe Kulturë.

¹⁵Takimi i trete në rang kombëtar u zhvillua në qytetin e Kavajës. Këshillat synojnë fuqizimin e rolit të grave në komunitete për të nxitur bashkëpunimin, kohezionin social dhe ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme, një program që do të zbatohet në Shqipëri nga IDM në bashkëpunim me Qendrën CVE, dhe Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve me mbështetjen financiare të GCERF.



Ky aktivitet i fokusuar në ngjarjet më të spikatura gjatë vitit 2021 përfshin nënshkrimin e Memorandumeve¹⁶ të bashkëpunimit me organizatat TdH, Zyrën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM), Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në kuadër të projektit “Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria apo për bashkëpunimin e ngushtë në ndërtimin e kapaciteteve ndër-institucionale për të përballuar sfidat e lidhura me rehabilitimin dhe ri-integrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Aktiviteti i QKEDH-së është udhëhequr nga bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe institucione të tjera që veprojnë për rritjen e kapaciteteve në fushat përkatëse. Në këtë kontekst janë edhe dy takimet e Drejtores së QKEDH-së me Drejtorin e Antiterrorit në Policinë e Shtetit dhe përfaqësues të Pikës së Kalimit Kufitar (PKK) Kapshticë, të Departamentit të Rendit Publik në DPPSH si dhe të Drejtorisë Vendore Korçë. Ky takim u fokusua në diskutimin e aktiviteteve të përbashkëta lidhur me identifikimin dhe parandalimin personave të radikalizuar që tentojnë të hynë në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet PKK apo kufirit të gjelbër, si dhe në kuadër të flukseve migratore nga vendet e Lindjes së Mesme.

¹⁶Më datë 01 shkurt 2021, znj. Lejdi Dervishi, Drejtori i QKEDH-së dhe znj. Enkelejda Kallçiu, Drejtori Kombëtar i TdH, nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimi mes tyre, qëllimi i të cilit është mbështetja e ofruar vendit tonë në kuadër të realizimit të procesit të ri-integrimit të fëmijëve të rikthyer nga zonat e konfliktit, projekt ky që po mbështetet nga donatori GCERF. Po në muajin shkurt, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Drejtorit të QKEDH-së dhe znj. Alma Jani, Drejtor i IOM në Shqipëri, në kuadër të Projektit Rajonal të Ballkanit Perëndimor “Ndërtimi i kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor për t’u marrë me sfidat në lidhje me ri-integrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit”, i financuar nga BE, projekt që do të zbatohet deri në muajin gusht të vitit 2023.

Gjatë vitit, QKEDH ka vijuar të procedojë edhe për zyrtarizmin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi qëllimi i së cilës mes të tjerave është realizimi i veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut; procesit të menaxhimit të të kthyerve në vendin tonë etj.

QKEDH ka dhënë kontributin e saj në trajnimin “Hulumtimi mbi Ekstremizmin e Dhunshëm dhe P/KEDH për Jo-hulumtuesit” i organizuar nga rrjeti “RESOLVE” dhe Instituti për Dialog Strategjik për temat e rëndësishë së kërkimit për praktikë dhe politikëbërje mbi ekstremizmin e dhunshëm.

QKEDH dhe misioni TdH kanë realizuar trajnime dy ditore me punonjës të bashkive organizuar në katër rajone: Tiranë dhe Durrës, Dibër, Korçë dhe Elbasan mbi “Pranimin dhe ndërveprimin e komunitetit ndaj të kthyerve nga zonat e luftës”¹⁷ me fokus rolin e Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) në kuadër të zbatimit të projektit “Reziliencë dhe Ri-integrim i Sigurt për fëmijët dhe nënat që kthehen nga zonat e luftës” që mbështetet financiarisht nga GCERF; sesione trajnuese me temë “Teknikat e intervistimit të të miturve të kthyer nga zonat e luftës” me psikologët e Qendrës Pritëse dhe oficerët e Drejtorisë së Anti-terrorit me qëllim rritjen e njohurive të psikologëve që punojnë në vijën e parë me të miturit e kthyer nga kampet e luftës, si dhe të aftësimit të oficerëve që merren me intervistimin e të miturve të kthyer nga zonat e luftës.

Rritje kapacitetesh me institucione të sistemit arsimor

QKEDH ka koordinuar dhe bashkëpunuar për realizimin e 28 (njëzetë e tetë) trajnimeve të mësuesve koordinatorë pjesë e rrjetit “Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, 9 (nëntë) prej të cilëve janë trajnime¹⁸ online ku kanë marrë pjesë 447 (katërqind e dyzetë e shtatë) mësues koordinatorë në Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare Korçë, Pogradec, Librazhd, Elbasan, Cërrik, Bulqizë, Kurbin, Lezhë, Shkodër, Durrës, Lushnje, Fier, Tiranë, Berat dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) janë trajnime të realizuara fizikisht me prezencën e 929 (nëntëqind e njëzetë e nëntë) mësuesve koordinatorë në zyrat vendore Divjakë, Ura Vajgurore, Kuçovë, Kukës, Delvinë, Sarandë, Vlorë Përmet, Gjirokastrë, Tepelenë, Mallakastër, Krujë, Peqin, Rrogozhinë, Vorë, Kamëz, Shijak, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Korçë, Durrës, Elbasan, Librazhd, Cërrik, Berat/Fier, Lushnje, Shkodër, Bulqizë, Tiranë.

¹⁷Me mbështetje financiare të Global Community Engagement and Resilience Fund.

¹⁸Mësuesit koordinatorë u informuan mbi shenjat që shfaqin fëmijët e radikalizuar, faktorët që shtojnë të rinjtë drejt radikalizimit, si dhe mbi mekanizmin bashkëpunues e referues që ekziston në nivel shkolle dhe në nivel vendor gjatë trajnimit që u zhvillua në kuadër të zbatimit të projektit “Promovimi i edukimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm” implementuar nga organizata SHIS e financuar nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë.

Gjithashtu ka realizuar 5 (pesë) trajnime online me 150 (njëqind e pesëdhjetë) oficerë të sigurisë në shkollë të Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Lezhë, Fier dhe Korçë në kuadër të projektit “Shkolla si qendër kryesore e sigurisë - rritja e kapaciteteve të oficerëve të sigurisë në shkollë për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe për të ndihmuar në ri-integrimin e të rinjve shqiptarë”¹⁹ ; si dhe trajnimin²⁰ për 220 (dyqind e njëzetë) të rinj në 11 (njëmbëdhjetë) bashki të vendit (Elbasan, Peqin, Librazhd, Cërrik, Belsh, Përrenjas, Gramsh, Rrogozhinë, Kavajë, Pogradec, Lushnjë) me qëllim krijimin e Forumit Rinor për Paqe dhe Siguri.

QKEDH në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe MAS ka realizuar 5 (pesë) aktivitete “Talk Shows” me nxënës të shkollave në disa zona rurale të vendit²¹ me qëllim nxitjen e nxënësve drejt të menduarit kritik si dhe rritjen e nivelit të debatit mbi ekstremizmin e dhunshëm. Me mbështetjen e zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë këtij viti u realizua edhe trajnimi me temë “E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/KEDH– standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre”.²²



¹⁹Projekti realizohet në bashkëpunim me MASR-në dhe AHS mbështetur nga Ambasada e SHBA-së.

²⁰Projekti: “Një qasje e integruar për të promovuar gratë dhe të rinjtë Paqendertues në Shqipëri” u hartua nga WCDCA në kuadër të projekteve për promovimin e paqes & sigurisë për përfshirjen e grave, të rinjve dhe të rejave në procesin e implementimit në Shqipëri të rezolutave 1325 dhe 2250 të KB.

²¹Trajnimet u zhvilluan me nxënës të shkollave të mesme “Kajo Karafili” Durrës, “Ibrahim Muça” Librazhd, “28 Nëntori” Burrel, Gjimnazi në Rrëshen dhe “Asim Zeneli” Gjirokastrë në kuadër të projektit “Konsolidimi i Qëndrueshmërisë Komunitare ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm duke fuqizuar Rininë” mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve.

²²Ky trajnim realizohet në kuadër të detyrimeve institucionale që derivojnë nga Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe ligji LIGJ Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Rritje kapacitetesh me institucione të sistemit të shëndetësisë

QKEDH në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) si dhe me partnerët IOM dhe IANS kanë realizuar 4 (katër) trajnime²³ me pjesëmarrjen e 70(shtatëdhjetë) aktorëve të vijës së parë²⁴.

QKEDH në koordinim me zyrën IOM ka zhvilluar trajnimin mbi metodologjinë MoviEQ²⁵ me grupin e përzgjedhur “Trajnerë të Trajnerëve” (ToT) për fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë. Gjithashtu, në koordinim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) dhe me partnerin TdH, QKEDH ka realizuar një cikël trajnimi²⁶ 6 ditor me aktorët e vijës së parë në qarqet Dibër, Elbasan, Durrës, Korçë dhe Tiranë.

Rritje kapacitetesh me institucione të sistemit të drejtësisë

Këshilli i Evropës ka organizuar në shkurt të këtij viti “Promovimi i kursit HELP për parandalimin e radikalizmit në Shqipëri”, në qendër të të cilit ishte prezantimi i një kursi²⁷ trajnimi të personalizuar për Shqipërinë me njohuri për adresimin e çështjeve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këta sektorë. Aktiviteti vjetor vijon kur përmes partnerit implementues IANS, QKEDH në bashkëpunimin me DPB organizuan forumin²⁸ ndër-institucional për aspektet e rehabilitimit dhe të ri-integrimit mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm të të burgosurve nëpër burgje.

Po me këtë fokus, QKEDH ka kontribuar në dy takimet e Forumit të 3të ndër-institucional për P/KEDH në burgje me profesionistët e vijës së parë në qytetet Elbasan dhe Korçë, si dhe në Forumin e V-të Ndër-institucional në Lezhë të organizuara në kuadër të programit “Përmirësimi i kapaciteteve penitenciare për adresimin e radikalizmit në burgje në Ballkanin Perëndimor”.

²³Tema e trajnimeve: “Çfarë na bën të cenueshëm ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm” si dhe “Procesi i rehabilitimit dhe ri-integrimit të Luftëtarëve të Huaj Terroristë dhe familjeve të tyre-rasti Cërrik”.

²⁴Ibid.

²⁵Trajnimi bashkoi 17 punonjës nga QKEDH, MSHMS dhe institucioneve të varësisë, Bashkia Cërrik, Mat, Pogradec dhe Tiranë dhe u fokusua në njohjen, përdorimin si dhe përcjelljen e dijeve mbi metodologjinë MoviEQ.

²⁶Trajnimi u realizua në kuadër të projektit “Qëndrueshmëri dhe ri-integrim i sigurt për fëmijët dhe nënat e rikthyera nga zonat e konfliktit” me implementues TdH dhe me mbështetje financiare të GCE për rritjen e kapaciteteve të 80 pjesëmarrësve për menaxhimin e rasteve gjatë procesit të ri-integrimit në komunitet të fëmijëve dhe familjeve të prekura nga fenomeni i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

²⁷Morën pjesë 25 punonjës të sistemit të burgjeve dhe shërbimit të provës në vend.

²⁸Aktiviteti u zhvillua me mbështetjen e BE-së dhe Këshillit të Evropës përmes programit “Horizontal Facility for the Western balkans and Turkey 2022-2012”.

Rritje kapaciteteve të punonjësve të QKEDH-së

Rritjen e kapaciteteve të punonjësve të saj, QKEDH e ka cilësuar një nevojë të vazhdueshme me qëllim përmbushjen e misionit të saj. QKEDH ka bashkëpunuar dhe marrë pjesë, përgjatë këtij viti në 7 (shtatë) trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të saj.

Dy prej trajnimeve²⁹ janë realizuar në koordinim dhe bashkëpunim me KDIMDP ku janë trajtuar çështjet e informimit të publikut, ruajtjes të të dhënave personale, si dhe kufizimet e mundshme në këto aspekte që vijnë si pasojë e kryerjes së veprimtarisë së punë së QKEDH-së me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Brendshme (MB), si dhe nga strukturat që punojnë në fushën e P/KEDH.

QKEDH ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI) në bashkëpunim me KDIMDP mbi mënyrën e përdorimit të sistemit AMS për pritjen e aplikimeve për kërkesat dhe kthimin e përgjigjeve për qytetarin në rastet kur informacioni kërkohet elektronikisht nëpërmjet portalit e-Albania.

Me qëllim rritjen e njohurive profesionale për procesin e prokurimeve, QKEDH ka marrë pjesë në trajnimin³⁰ online organizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) që u zhvillua në kuadër të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe miratimit të VKM-së “Për rregullat e prokurimit publik”; në trajnimin e organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) mbi ligjin e ri të prokurimeve publike, risitë dhe ndryshimet në këtë ligj; si dhe në trajnimin e Inspektoriatit të Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) në bashkëpunim me projektin “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë “ i bashkëfinancuar nga BE/KE mbi mënyrën e përdorimit të sistemit elektronik për menaxhimin e llogarive të subjekteve të detyruara ligjërisht në institucion për plotësimin e formularit të deklarimit të pasurisë.

²⁹“E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/KEDH-së – standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre”.

³⁰Në trajnim morën pjesë rreth 50 pjesëmarrës nga Autoritetet dhe Entet Kontraktore, 7 pjesëmarrës nga QKEDH.

1.3 KOMUNIKIMI STRATEGJIK

Komunikimi Strategjik është një ndër objektivat më të rëndësishëm ku është fokusuar puna e QKEDH-së që nga momenti i krijimit të funksionimit të tij si institucion me fushën e veprimi në parandalimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm.

Finalizimi i studimit “Eksplorimi i zhvillimit të një komunikimi strategjik në P/KEDH në Shqipëri - Qasje e bazuar në kërkim”³¹ realizuar në bashkëpunim me CSDG dhe publikimi³² i studimit në faqen WEB të QKEDH-së është tregues i punës së kryer në përmbushje të këtij objektiivi në parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm. Bashkëpunimi³³ me CSDG ka vijuar për realizimin e projektit³⁴ pilot “Mbështetja e QKEDH-së në përhapjen e komunikimit strategjik për P/KEDH nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve dhe hulumtimit” me mbështetjen e Ambasadës së SHBA në Shqipëri.

Një tjetër arritje është hapja e rubrikës dedikuar rrjetit të mësuesve koordinatorë kundër ekstremizmit të dhunshëm në faqen zyrtare të MAS³⁵ si rezultat i koordinimit dhe bashkëpunimit të QKEDH me MAS dhe organizatës SHIS³⁶.

Gjatë vitit 2021 janë 12 (dymbëdhjetë) bashkëpunime me mediat, duke përfshirë daljet publike, intervistat si dhe përfshirje në emisione televizive me temën e parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Drejtori i QKEDH-së znj. Lejdi Dervishi ka marrë pjesë në panelin e të ftuarve në emisionin “Real Story”³⁷ të gazetarit Sokol Balla; **në emisionin televiziv italian TodayTv2000** nga gazetari Andrea Sarubbi me fokus tek harmonia fetare si një faktor kyç për të parandaluar fenomenin në Shqipëri³⁸; dhe ka dhënë një intervistë³⁹ të strukturuar në televizionin shqiptar MCM.

³¹Ky raport është përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me mbështetjen e Hedayah, Qendrës Ndërkombëtare të Ekselencës për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm financiar nga BE.

³²<https://cve.gov.al/qendra-e-koordinimit-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem-publikoi-studimin-eksplorimi-i-zhvillimit-te-nje-komunikimi-strategjik-ne-p-cve-ne-shqiperi-qasje-e-bazuar-ne-kerkim/>.

³³Drejtori i QKEDH zhvilloi një takim online me përfaqësues të organizatës Hedayah dhe CSDG mbi zhvillimin e koncept-notës për hartimin e projektit pilot për shpërndarjen e kundër-narrativave në tre zona në Bashkisë Tiranë me qëllim informimin e publikut mbi rreziqet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Projekti nisi zbatimin në korrik të këtij viti duke synuar adresimin e disa mangësiëve, vënien në pah të rolit të rëndësishëm të QKEDH në koordinimin e këtij procesi si dhe nevojën për mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve dhe konsolidimin e praktikave bashkëpunuese mbi zhvillimin dhe zbatimin e komunikimeve që lidhen me parandalimin dhe luftimin e propagandës islamike në nxitjen e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

³⁴Qëllimi i projektit është të mbështesë QKEDH dhe ministrinë e linjës të përfshira në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm nëpërmjet në përmirësimin e kapaciteteve në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të komunikimit strategjik për parandalimin dhe kundërvënien e propagandës së dhunshme ekstremiste. Parashikohen të zhvillohen disa workshop-e/trajnime me punonjës nga ministrinë përkatëse të linjës, të cilat do të synojnë përmirësimin e njohurive dhe ekspertizës në zhvillimin dhe zbatimin e mesazheve që lidhen me parandalimin dhe kundërvënien ndaj propagandës së dhunshme ekstremiste.

³⁵<http://arsimi.gov.al/parandalimi-i-ekstremizmit-ne-arsim/>.

³⁶SHIS është zbatuese e projektit “Promovimi i edukimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm” i cili mbështetet financiarisht nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë.

³⁷Link: https://www.youtube.com/watch?v=mK8KIW3_a0E&feature=emb_imp_woyt..

³⁸<https://www.tv2000.it/today/>.

³⁹Prezantimi i aktivitetit që kryen QKEDH në parandalimin e fenomenit dhe ecurinë e fazës së dytë të procesit të ri-integrimit të të riadhesuarve në vend.


QKEDH ka koordinuar dhe bashkëpunuar në realizimin e 27 (njëzetë e shtatë) intervista me përfaqësues të lartë institucionesh në vend, me krerët e komuniteteve fetare në vend, si dhe me punonjës të vijë së parë për të realizuar një cikël reportazhesh⁴⁰ nga Qendra Media Aktive me qëllim evidentimin e bashkëpunimit kundër ekstremizmit të dhunshëm ndërmjet institucioneve të shtetit shqiptar, shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare.

Pasqyrim mediatik⁴¹ ka gjetur edhe “Prezantimi i portalit unik për sinjalizimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme” aktivitet që u organizua nga Akademia e Studimeve Politike (ASP), QKEDH dhe AKCESK.

Një moment i rëndësishëm është edhe fakti se gjatë këtij viti QKEDH u bë pjesë në fushatën mediatike **“One Mission Many Nations”** në kuadër të Grupit të Punës të Koalicionit Ndërkombëtar kundër DAESH/ISIS të OKB-së.

Po në përmbushje të këtij objekti, QKEDH ka kontribuar pranë IANS dhe Qendrën Fokus, për videon e realizuar në kuadër të programit⁴² dy vjeçar të zbatuar në Bashkinë Cërrrik, ku Drejtori i QKEDH referon ndërhyrjet e realizuara në kuadër të iniciativës duke transmetuar mesazhe ndërgjegjësuese për grupin e interesit konsultues të videos.

Bashkëpunimi Institucional



- Konferenca Kombetare, Rajonale, Ndërkombëtare
- Tryeza PUNE të Përbashkëta

⁴⁰ Financuar nga Ambasada Amerikane në Tiranë dhe Departamenti Amerikan i Shtetit.

⁴¹ <https://www.zeriamerikes.com/a/5931219.html>.

⁴² Është programi i parë pilot në vend që synoi rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave të kthyer nga zonat e konfliktit dhe familjeve të tyre në Bashkinë e Cërrikut që u mbështet nga programi MATRA i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

1.4 Bashkëpunime me Partnerë në Nivel Kombëtar/ Rajonal/ Ndërkombëtar

Në kontekstin e produkteve të arritura si rezultat i bashkëpunimit me partnerë në të gjitha nivelet e tij është kontribuar/realizuar në produkte në formën e materialeve/studimeve, tryeza pune të përbashkëta të zhvilluara onsite apo online një pjesë e tyre, si dhe konferenca/videokonferenca.

Bashkëpunime dhe veprimtari të realizuara në nivel kombëtar

Iniciativa e Kryeministrit "Gati për Shqipërinë" evidentoi mbështetjen e institucionit tonë për të angazhuar të rinj dhe të reja me ekspertizë ndërkombëtare për çështje të ekstremizmit të dhunshëm. Në kuadër të kësaj iniciative, Drejtori i QKEDH-së u takua me Këshilltarin e Sigurisë së Kryeministrit mbi mbështetjen e dhënë nga institucioni ynë, i vijuar me takimet institucionale të zhvilluara për zbatimin dhe ecurinë e Planit të ri-integrimit në vend për 24 (njëzet e katër) të riatdhesuarit nga vendet e Sirisë dhe Irak.

Peshë të veçantë merr edhe event i organizuar nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV) ku u prezantua Linja Telefonike Kombëtare për Ekstremizmin e Dhunshëm, si dhe u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet QKEDH, MB dhe LKGV⁴³, marrja pjesë në konsultimin publik të draft-strategjisë të MAS për arsimin 2021-2026, si dhe takimi me Drejtorin e Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) për fuqizimin e rolit të Këshillave Vendorë për Sigurinë Publike (KVSP), si një element kyç në kuadër të parandalimit të fenomeneve të radikalizmit dhe ekstremizmit në nivel vendor.

⁴³Link video nga takimi: <https://sq-al.facebook.com/LinjeKeshillimit/videos/430548058062268/>.



QKEDH nënshkruan Marrëveshje Mirëkuptimi me Ministrinë e Brendshme dhe Linjën e Këshillimit për Gra dhe vajza ku prezantohet Linja Telefonike Kombëtare për Ekstremizmin e Dhunshëm, Tiranë, 18. 02.2021



Strategjia e re Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit 2022-2026

Bashkëpunimi ndër-institucional gjatë vitit 2021 u reflektua edhe me nisjen e procesit të hartimit të Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit 2022-2026, i cili është një prej prioriteteve të punës së institucionit i shpallur që në vitin 2020.

Që nga muaji korrik kur nisi ky proces, janë zhvilluar 13 (trembëdhjetë) takime me ekspertët⁴⁴ e kontraktuar si dhe me përfaqësues institucionale. Pas takimit me ekspertët e angazhuar të TdH -së që po asistojnë të gjithë procesin e hartimit të Strategjisë së re janë zhvilluar 4 (katër) tryeza pune me Grupin Ndër-institucional të Punës (GNP), i ngritur për këtë qëllim.

Strategjia e re Kombëtare u diskutua me prioritet me përfaqësuesin e Departamentit Rregulator dhe Përputhshmërisë për Projekt-aktet 2022, pranë Kryeministrit në kuadër të fazës përgatitore për hartimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt-akteve për vitin 2022 mbështetur në Urdhrin nr.19. Date. 5.11.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

⁴⁴Ekspertët e angazhuar nga organizata TdH asistojnë procesin e hartimit të Strategjisë së re Kombëtare 2022-2026

Bashkëpunime dhe veprimtari të realizuara në nivel rajonal

QKEDH ka organizuar me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri konferencën rajonale “Roli i gruas kundër ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor” me fokus rolin e grave në parandalimin dhe luftën kundër fenomenit.

QKEDH ka prezantuar rolin dhe misionin e saj duke theksuar rolin e integritit të grave në institucione të sigurisë gjatë trajnimit “Institutin për Gratë dhe Vajzat në Politikave të Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare II” që u organizua nga Qendra e Studimit të Politikave Evropiane për Zhvillimin Rajonal dhe Lokal, me mbështetje financiare të Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.

QKEDH ka kontribuar në Konferencën Rajonale “Media, terrorizmi dhe luftëtarët e huaj terroristë në Ballkanin Perëndimor – raste studimi” që u zhvillua në Kroaci; mori pjesë në konferencën rajonale “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin – Lidhja ndërmjet sistemit të drejtësisë për të miturit dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijëve” që u organizua nga TdH në partneritet me Defence for Children International në Holandë (DFC-NL), në konferencën online “Komuniteti i -5të Global i Praktikës Gratë, Burrat dhe Agjencitë e Komunitetit” që organizoi GCERF ka marrë pjesë në simpoziumin e Shkupit që organizoi po partneri GCERF në kuadër të projektit mbi rehabilitimin e bazuar në komunitet të të kthyerve nga zonat e luftës, si dhe në takimin rajonal prezantues në kuadër të projektit⁴⁵ «Ndërtimi i kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor për tejkalimin e sfidave në lidhje me ri integrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terroristë (FTF) dhe familjeve të tyre nga zonat e konfliktit» që implementon IOM.

Në këtë nivel bashkëpunimi evidentohet kontributi i znj.Dervishi në punimet e Platformës⁴⁶ Kombëtare për Luftën kundër EDH të Malit të Zi, si dhe në workshop-in e organizuar nga RAN, me temë: “Komunikimi Strategjik mbi LHT-të dhe familjarët e tyre të kthyer në Ballkanin Perëndimor”. QKEDH ka dhënë kontributin e saj në çeljen e Rrjetit të Ballkanit Perëndimor (BP) për të rikthyerit, të cilin Shqipëria do ta bashkë-drejtojë për 6 muajt në vijim.

⁴⁵Projekti financohet nga BE.

⁴⁶Punimet e Platformës u mbajtën në 9-10 Dhjetor 2021.

Partneriteti me homologët e Republikës së Kosovës

Shkëmbimi i përvojave dypalëshe për aspekte penale dhe elemente të tjerë të procesit të ri-integrimit është arsyeja e zhvillimit të takimit që QKEDH koordinoi dhe realizoi me kërkesë të homologëve nga Republika e Kosovës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Drejtorisë së Antiterrorit dhe Divizionit.

QKEDH me bashkëpunim MAS, pas takimit me delegacionin kosovar të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, koordinatore të grupit teknik për çështjet e P/KEDH pranë kësaj ministrie, si dhe profesorë të asociuar në Universitetin e Prishtinës, konkluduan hartimin e një agjende për realizimin e ndërhyrjeve të përbashkëta në fushën e parandalimit dhe ri-integrimit për arsimin parauniversitar dhe të lartë.

Përmes qëndrueshmërisë së spikatur të këtij bashkëpunimi, u vijua me vizitën studimore në Prishtinë në kuadër të projektit⁴⁷ “Universitetet fronti i ri i QKEDH - rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të aktorëve të arsimit universitar në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm”.



QKEDH në takim me homologët kosovarë në vazhden e takimeve të zhvilluara mes dy palëve me qëllim shkëmbimin e përvojave të tyre në zbatim të procesit të ri-integrimit për të riatdhesuarit nga vendet e konfliktit. Tiranë 8.04.2021



⁴⁷Zbatohet nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.

Partneriteti me Koordinatorët Kombëtarë të P/KEDH në Rajonin e Ballkanit Perëndimor

QKEDH ka marrë pjesë dhe kontribuar në takimet që ka zhvilluar Rrjeti Rajonal i Koordinatorëve Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Në takimin⁴⁸ e VIII-të që zhvilloi ky Rrjet, Drejtori i QKEDH prezantoi punën që është realizuar në kuadër të programeve R&R dhe risocializimin e të kthyerve nga kampet në zonat e luftës.

Gjatë vitit 2021, dy homologët⁴⁹, i Shqipërisë dhe i Malit të Zi janë dakordësuar për të bashkëpunuar në parandalimin e fenomenit në fushën e edukimit si dhe në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë duke u bazuar në ekspertizën dhe eksperiencën e modelit të ndërtuar nga QKEDH e Shqipërisë, ndërsa gjatë takimit⁵⁰ që u zhvillua me palën maqedonase, homologë e të dy vendeve respektive prezantuan eksperiencat e qeverive përkatëse mbi proceset e R&R të LHT-ve dhe familjeve të tyre.

⁴⁸Tetor 2021.

⁴⁹Drejtori i QKEDH-së znj. Lejdi Dervishi dhe Koordinatori Kombëtar i Malit të Zi, z. Rade Milosheviç, njëherazi Sekretar Shteti i Ministrisë së Brendshme, zhvilluan një takim gjatë muajit Maj dhe ku ranë dakord që do të bashkëpunojnë për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm në fushën e edukimit si dhe do të bashkëpunojnë në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë duke kërkuar ekspertizën dhe eksperiencën e modelit të ndërtuar nga QKEDH e Shqipërisë.

⁵⁰Në muajin shtator, QKEDH zhvilloi në qytetin e Pogradecit një takim dypalësh me homologun maqedonas, me qëllim “Ndarja e modeleve më të mira mbi proceset e Rehabilitimit dhe Ri-integrimit të LHT-ve dhe familjeve të tyre midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë”.

Partneriteti me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC)

Konferenca e mbajtur mbi impaktin e krizës në Afganistan në Ballkanin Perëndimor për çështjet e sigurisë dhe ekonomike që u organizua nga Regional Cooperation Council (RCC) është një prej partneriteteve më të shënuara gjatë aktivitetit që ka zhvilluar QKEDH gjatë vitit 2021. Znj. Dervishi si pjesë e panelit të konferencës u ndal në pritjen dhe akomodimin që iu bë refugjatëve afganë në Shqipëri gjatë muajve Gusht dhe Shtator 2021, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 501 datë 25.08.2021.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal organizoi Konferencën e Gjashtë Koordinuese Rajonale (Jumbo) të Sigurisë “Rritja e bashkëpunimit rajonal të sigurisë: një shtyllë e rrugës evropiane të Ballkanit Perëndimor” ku znj. Dervishi prezantoi arritjet dhe aktualitetin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri.

Partneriteti me RCC përfshin pjesëmarrjen e QKEDH-së në takimin⁵¹ e Rrjetit Ndërgjegjësues për Radikalizmin (RAN) që kishte në fokus të rinjtë dhe angazhimin e tyre për sa i përket parandalimit të fenomenit, si dhe në eventin lançues të RCC-së gjatë të cilit u paraqit edicioni i parë i Sondazhit të Opinionit Publik të Sigurisë (#SecuriMeter) 2021: “Qëndrimet ndaj sigurisë:

Perceptimet e sigurisë dhe kërcënimet në Ballkanin Perëndimor”.



Foto nga Konferenca e Gjashtë Koordinuese Rajonale e Sigurisë “Rritja e bashkëpunimit rajonal të sigurisë: një shtyllë e rrugës evropiane të Ballkanit Perëndimor”,

Paris 06.12.2021

⁵¹Mars 2021.

Bashkëpunime dhe veprimtari të realizuara në nivel ndërkombëtar

Në këtë nivel bashkëpunimi, institucioni ynë ka zhvilluar një aktivitet të qenësishëm. Janë 29 (njëzetë e nëntë) konferenca /videokonferenca si dhe 44 (dyzetë e katër) takime online dhe onsite të zhvilluara në kontekstin e tij.

I tillë është aktiviteti i institucionit tonë në kuadër të vizitës që kreu delegacioni⁵² nga Emiratet e Bashkuara Arabe i kryesuar nga kreu i Qendrës Ndërkombëtare të Përsosmërisë për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Hedayah)⁵³.

Gjatë vitit 2021, evidentojmë mes angazhimeve të tjera se znj. Lejdi Dervishi ka marrë pjesë në Sesionin e II-të Ndërkombëtar mbi Ballkanin “Franca, Ballkani dhe Evropa në një kontekst strategjik të paqëndrueshëm” që u organizua nga Ministria franceze për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Instituti i Lartë për Studimet e Mbrojtjes si dhe në Kursin⁵⁴ e Avancuar të Programit të Shkencës për Paqe dhe Siguri të NATO-s «Përfshirja Gjimore në Përpjekjet Kundër-terrorizmit në Ballkanin Perëndimor» ku prezantoi ndërhyrjet shtetërore dhe politikat që janë zbatuar në vendin tonë për avancimin e barazisë gjimore si dhe qasjen e institucionit tonë mbi ndërhyrjet e ‘qasjes së butë’ dhe ‘qasjes së fortë’ në këtë fushë.



Foto nga Konferenca e Gjashtë Koordinuese Rajonale e Sigurisë “Rritja e bashkëpunimit rajonal të sigurisë: një shtyllë e rrugës evropiane të Ballkanit Perëndimor”, Paris 06.12.2021



KE organizon konferencën “Roli i grave dhe fëmijëve në terrorizëm”, Znj. Lejdi Dervishi prezanton progresin e Shqipërisë në proceset Rehabilitimit, Ri-integritit dhe Ri-socializimit të të riatdhesuarve nga ish-vendet e konfliktit Siri dhe Irak. Strasbourg, 16.12.2021

⁵²Delegacioni i përbërë nga shtatë anëtarë i kryesuar nga i kryesuar nga SH.T.Z Dr. Ali Rasheed Al Nuaimi, kryetar i organizatës Hedayah përcolli konsideratat e tij drejt palës shqiptare për të gjitha rezultatet e arritura përmes punës së QKEDH-së duke theksuar rëndësinë e partneritetit dhe bashkëpunimit mes QKEDH-së dhe Hedayah.

⁵³Organizata Hedayah është organizata kryesore ndërkombëtare e përkushtuar për të përdorur ekspertizën dhe përvojat e saj për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm në të gjitha format dhe manifestimet e tij përmes dialogut, komunikimeve, programeve të ngritjes së kapaciteteve, kërkimit dhe analizës dhe është një partner kyç i QKEDH-së. Hedayah ka mbështetur Shqipërinë me qëllim ngritjen në mënyrë efektive të kapaciteteve të aktorëve për të promovuar tolerancën, stabilitetin dhe sigurinë. E financuar nga BE, organizata Hedayah ka bashkëpunuar me QKEDH përmes CSDG duke realizuar studimin “Eksplorimi i zhvillimit të një komunikimi strategjik në P/KEDH në Shqipëri – Qasje e bazuar në kërkim” Link i vizitës së Hedayah në QKEDH: <https://cve.gov.al/drejtori-i-qendres-cve-mirepret-delegacionin-nga-emiratet-e-bashkuara-arabe-te-kryesuar-nga-kreu-i-organizates-hedayah-2/>

Partneriteti me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Bashkëpunimi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është i një rëndësie të veçantë për institucionin tonë. Gjatë periudhës referuese, bashkëpunimi startoi me takimin prezantues që u zhvillua me Ambasadorin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Z. Del Monaco, i cili e mori këtë funksion në muajin dhjetor të vitit 2020, ka vijuar me zhvillimin e dy konferencave⁵⁵ të rëndësishme të organizuara nga OSBE, me temë “Parandalimi i Terrorizmit dhe Luftimi i Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmi që çojnë në terrorizëm”, ku znj. Dervishi prezantoi rrugën progresive të Shqipërisë në parandalimin dhe kundërshtimin e këtij fenomeni duke e konkretizuar përmes historisë të një gruaje, ndërsa pjesëmarrja tjetër është në “Konferencën⁵⁶ e Gjerë të OSBE-së Kundër Terrorizmit” me praninë e personaliteteve të spikatura të fushës.

QKEDH ka koordinuar zhvillimin e aktivitetit të organizuar me Prezencën e OSBE-së në kuadër të prezantimit të raportit të vlerësimit për KVSP; ka marrë pjesë në seminarin⁵⁷ që zhvilloi kjo prezencë në Shqipëri dhe ministria e Mbrojtjes së Austrisë për rritjen e ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të sektorit të sigurisë dhe të shoqërisë civile për qeverisjen dhe reformën e sektorit të sigurisë, si dhe ka realizuar takime⁵⁸ vlerësuese mbi arritjet e kryera në institucionet penitenciare dhe shërbimin e provës në vend. Po në bashkë-koordinim me OSBE-në është organizuar konferenca e posaçme mbi parandalimin dhe dhënien fund të fenomenit ku morën pjesë Ambasadori⁵⁹ i Shqipërisë pranë OSBE-së dhe përfaqësues të partnerëve strategjik të palës shqiptare në fushën P/KEDH.



Gjatë konferencës rajonale “Roli i gruas kundër ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor” e organizuar nga QKEDH dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Punimet u përshëndetën nga kreu i OSBE-së, z. Vincenzo Del Monaco, Tiranë 14.10.2021

Partneriteti me Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB)

QKEDH ka marrë pjesë në dy konferencat e organizuara në kuadër të aktivitetit⁶⁰ të zhvilluar nga organizata ndërkombëtare e OKB-së, gjatë “Javës Kundër Terrorizmit” që synuan inkurajimin dhe përgatitjen e shteteve anëtare për sfidat që paraqiten lidhur me luftëtarët e huaj terroristë (LHT) dhe familjet e tyre.

Marrja pjesë në eventin në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të 76-të të OKB, “Efektet Zinxhir të Rënies së Afganistanit – Parandalimi i Terrorizmit me bazë në Komunitet” ku u prezantuan arritjet e Qeverisë Shqiptare dhe QKEDH-së në forcimin e institucioneve vendore për të luftuar dhe parandaluar fenomenin në nivel lokal është një tjetër moment i rëndësishëm i aktivitetit. Partneriteti vijoi me takimin virtual të grupit të punës të Koalicionit Global për Luftën kundër Luftëtarëve të Huaj Terroristë të ISIS, me fokus rolin e Task Forcës së Përbashkët; **dialogun⁶¹ virtual organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara Kundër Terrorizmit (UNOCT)** dhe Misioni i OKB-së në Spanjë “Dialog me Partnerët e të Drejtave të Njeriut dhe Shoqërisë Civile për të Ndërtuar një Paradigmë më të Mirë për Parandalimin dhe Luftën Kundër Terrorizmit”.

QKEDH ka marrë pjesë në “Side Event”-in e organizuar nga Rrjeti i Qyteteve të Forta (Strong Cities Network) në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ku janë pasqyruar arritjet e Qeverisë Shqiptare dhe Qendrës QKEDH në fuqizimin e institucioneve vendore për kundërshtimin dhe parandalimin e fenomenit nivel vendor.

⁵⁵Më 15.03.2021 u zhvillua konferenca me temë: “Parandalimi i Terrorizmit dhe Luftimi i Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmi që çojnë në terrorizëm”, ku znj. Dervishi prezantoi rrugën progresive të Shqipërisë në parandalimin dhe kundërshtimin e këtij fenomeni duke e konkretizuar përmes historisë konkrete të një gruaje.

⁵⁶Drejtori i QKEDH-së theksoi në fjalën që mbajti se Qeveria shqiptare ka një strategji të qartë dhe mbetet e përkushtuar ndaj P/KEDH-, nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse në mbrojtje të lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.

⁵⁷Qeverisja efektive e Sektorit të Sigurisë përmes partneritetit ndërmjet Institucioneve të Sektorit të Sigurisë dhe Shoqërisë Civile.

⁵⁸Për vlerësimin e pavarur të ndërhyrjeve të OSBE-së mbi forcimin e përgjigjeve të drejtësisë penale në përputhje me sundimin e ligjit ndaj terrorizmit gjatë periudhës 2014 – 2020.

⁵⁹Ambasadori i Shqipërisë pranë OSBE-së z.Igli Hasani, theksoi rolin e rëndësishëm të Shqipërisë në qasjen rajonale donatorit GCERF në Ballkanin Perëndimor për rehabilitimin dhe ri-integrimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë dhe të familjarëve të tyre, duke nënvizuar njëherazi edhe nevojën e përqendrimit në komunitet që është thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm në kuadër të parandalimit dhe dhënies fund të ekstremizmit të dhunshëm.

⁶⁰Aktiviteti u koordinua me MEPJ dhe Misioni i Shqipërisë në OKB për inkurajimin dhe përgatitjen e shteteve anëtare për sfidat që paraqiten lidhur me luftëtarët e huaj terrorist (LHT) dhe familjet e tyre si dhe informimin për mbështetjen që do të jap OKB për këto çështje delikate.

⁶¹U theksua rëndësia e respektimit të të drejtave të njeriut gjatë përpjekjeve kundër terrorizmit dhe roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit/respektimi i të drejtave të viktimave të terrorizmit, dhe u prezantua për herë të parë një dokumentar për gratë viktime të terrorizmit në Spanjë.

Partneriteti me Komisionit Evropian (KE) dhe me Këshillin e Evropës (KiE)

Në datën 23 nëntor 2021 në Ministrinë e Brendshme u zhvillua takimi midis përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe palës shqiptare ku u diskutua progresi i bërë në kuadër të implementimit të Planit të Përbashkët të Veprimit për Luftën Kundër Terrorizmit, mes BE-së dhe Vendeve të Ballkanit Perëndimor. Komisioni u njoh me ndërhyrjet e realizuara nga institucioni ynë dhe punën e realizuar nga strukturat shtetërore në kuadër të procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit të shtetasve të rikthyer nga zonat e konfliktit në komunitet.

QKEDH është vlerësuar si një model suksesi në rajon e më gjerë edhe në video-konferencën⁶² e zhvilluar po gjatë vitit 2021 me përfaqësues të KE-së.

Gjatë vitit 2021 u mbajtën punimet e Konferencës⁶³ Ndërkombëtare “Roli i grave dhe fëmijëve në terrorizëm” organizuar nga KE ku u prezantua progresi i Shqipërisë në kuadër të proceseve të RRR të riadhesuarve si dhe sfidat me të cilat përballen këto procese. Gjatë pjesëmarrjes në seminarin e dytë online të rrjetit HOPE “Një qasje shumë-agjencish ndaj parandalimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan, Evropën Jugore dhe Lindore: Nevojat e sistemit penitenciar” u eksploruan rezultatet e punës të KE-së lidhur me P/KEDH në Ballkanin Perëndimor.

Për sa i përket bashkëpunimit me Këshillin e Evropës (KiE) evidentojmë qasjen e angazhimit të të gjithë aktorëve të shoqërisë të nxitur nga institucioni shprehur gjatë takimit dypalësh mes Drejtorit të QKEDH-së dhe Kreut të Zyrës së Këshillit të Evropës ⁶⁴në Tiranë, si dhe pjesëmarrja e institucionit në video-konferencën ⁶⁵“Takimi i Dytë i Komitetit Drejtues të Instrumentit Horizontal II”, Workshop 1: Sigurimi i drejtësisë. Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri (SEJ3)”.

⁶²Video-konferenca u zhvillua më Qershor 2021 mbi implementimin e Planit të përbashkët të veprimit kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm për Ballkanin Perëndimor.

⁶³U mbajt më datën 15-16 Dhjetor në Strasburg.

⁶⁴Drejtori i QKEDH-së ka zhvilluar takim me përfaqësuesin politik të Delegacionit të BE-së në Shqipëri mbi Progres Raporti i BE-së i cili u publikua 19 tetor 2021 për sa i përket çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

⁶⁵Fokusi i punimeve ishte mbi mbështetjen për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për lehtësimin e ekzekutimit të vendimeve të GjEDNj – D-REX dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të të burgosurve në Shqipëri.

Partneriteti me përfaqësitë diplomatike në vend

Mbështetja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) ka vijuar të jetë domethënëse për QKEDH. Koordinimi ndër-institucional ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre vendore si dhe çështjet logjistike për pritjen dhe akomodimin e shtetasve shqiptarë para finalizimit të procesit të tretë të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak më 1 gusht 2021, kanë qenë tema e agjendës së takimeve të zhvilluar me përfaqësues të Ambasadës së SHBA-ve apo me Këshilltarin Ligjor të OPDAT në Shqipëri, për të vazhduar në vijim me bashkëpunimin të konsoliduar dhe që vijon të fuqizohet duke përfshirë edhe zbatimin e projekteve që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kapaciteteve për parandalimin e fenomenit.

Në kontekstin e këtij bashkëpunimi, QKEDH dhe IOM përmbyllën projektin “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet zërave lokalë dhe iniciativën lokale në Ballkanin Perëndimor”⁶⁶ të Departamentit Amerikan të Shtetit si dhe prezantuan objektivat për vitin 2022.

Partneriteti⁶⁷ përfshin takime me përfaqësues të niveleve më të larta të përfaqësive diplomatike në vend për nxitjen e aktiviteteve dhe projekteve ambicioze mbi parandalimin e fenomenit në vendin tonë si dhe në realizimin sa më eficient të procesit RRR.



Drejtori i QKEDH përshëndeti konferencën hapëse të fazës së tretë të projektit “Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm” të organizuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me mbështetjen financiare të Ambasadës së SHBA-ve.

Workshop përmbyllës i: “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet zërave lokalë dhe iniciativën lokale në BP” Link:<https://cve.gov.al/workshop-ne-permbyllje-te-projektit-parandalimi-i-ekstremizmit-te-dhunshem-nepermjet-zerave-lokale-dhe-iniciativen-lokale-ne-ballkanin-perendimor/>

⁶⁶QKEDH dhe IOM (zbatuese e projektit) organizuan në muajin Tetor 2021 workshopin e përmbjlljes së projektit “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet zërave lokalë dhe iniciativën lokale në Ballkanin Perëndimor”. Gjatë workshopit, znj. Dervishi, prezantoi aktivitetin e institucionit të kryer në kuadër të këtij projekti si edhe më gjerë. U krye Rishikimi i Planit të Punës të aktiviteteve të QKEDH dhe u prezantua planifikimi për 6 muajt e ardhshëm dhe objektivat për vitin 2022.

⁶⁷Drejtori Dervishi u takua me Zv./Ambasadorin e Italisë në Shqipëri, z. Alberto Petrangeli ku u dakordësua nga palët që përveç propozimeve lidhur me parandalimin e fenomenit, të mund të zhvillohen aktivitete kulturore-edukative me Kooperacionin Italian në Shqipëri, për promovimin e konceptit të Partneritetit Publik-Privat me fokus kundërshtimin e këtyre fenomeneve. Gjatë muajit tetor 2021, znj. Dervishi u takua me Atasheun e Sigurisë së Brendshme të Ambasadës Franceze në Tiranë dhe Koordinatorin e Qendrës franceze për Sigurinë në Evropën Juglindore, përfaqësues i Ambasadës Franceze në Serbi me fokus prioritetet e Qeverisë Shqiptare mbi parandalimin e fenomenit, proceset R&R si dhe propagandën online mbi ekstremizmin e dhunshëm. Znj. Dervishi ka zhvilluar takim edhe me z. Marco Berdetti të shoqëruar nga stafi i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë si dhe koordinatoret rajonale e Mbretërisë së Bashkuar për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm ku diskutuan mbi arritjet e deritanishme në parandalimin e fenomenit si edhe mbi hapat e ndërmarra në kuadër të programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit.

Partneriteti me Fondin e Emergjencës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)

Bashkëpunimi me partnerin ndërkombëtar, UNICEF u fokusua në angazhimin konkret mbi çfarë dhe si mund UNICEF të kontribuonte dhe mbështeste Republikën e Shqipërisë në parapërgatitjen logjistike për pritjen, rehabilitimin dhe ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të gjendur në zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme. **Ky bashkëpunim u konkretizua kur QKEDH ndërmoi masa për vendosjen në dispozicion të paketës humanitare për 72 orët e para të riatdhesimit të 19 shtetasve shqiptarë në fillim gushtin e vitit 2021.** Në bashkëpunim edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare në vend, QKEDH dhe UNICEF⁶⁸ koordinuan punën për të vënë në dispozicion të gjithë mbështetjen logjistike dhe ekspertizën e nevojshme për pritjen dhe akomodimin e këtyre shtetasve.

Bashkëpunimi me Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC)

Në kuadrin e bashkëpunimit me palët e treta, QKEDH ka një bilanc prej 56 (pesëdhjetë e gjashtë) takimesh të zhvilluara si dhe pjesëmarrje në një sërë aktivitetesh në kuadër të ushtrimit të misionit të saj koordinues.

QKEDH së bashku me Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) ka realizuar trajnimin⁶⁹ kombëtar “Roli i aktorëve në nivel lokal për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. Qasja e të gjithë shoqërisë” të aktorëve lokalë dhe Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) që punojnë për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Shqipëri. Vend të rëndësishëm në këtë partneritet zë edhe bashkëpunimi me organizatat⁷⁰ LKGV, IDM, TdH në zbatimin e Planit të Ri-integrimit për shtetasit e riatdhesuar nga vendet e konfliktit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi u bë i mundur trajnimi “Mbështetja rehabilituese dhe ri-integruese për personat që kthehen nga zonat e konfliktit”⁷¹ i realizuar nga IDM për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike dhe profesionistëve të vijës së parë mbi zhvillimin dhe zbatimin e proceseve R&R.

⁶⁸Përfaqësuesi i lartë i UNICEF në Shqipëri z. Roberto De Bernardi vizitoi gjatë muajit shtator ambientet e Qendrës Pritëse që u mundësua nga QKEDH në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm të UNICEF dhe institucionit tonë .

⁶⁹Trajnimi u organizua në kuadër të projektit “Komunitetet të parat: krijimi i një rrjeti të organizatave të shoqërisë civile për të adresuar ekstremizmin e dhunshëm - nga parandalimi në ri-integrim” me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkive Tiranë, Shkodër, Cërrik, Mat, si dhe aktorë të rëndësishëm të vijës së parë, përfaqësues të institucioneve arsimore, shëndetësore, organizatave partnere, grupeve rinore, komuniteteve fetare.

⁷⁰Organizatat LKGV, IDM, TdH janë fituese të procesit të aplikimeve të shpallur gjatë vitit 2020 nga GCERF me qëllim koordinimi i ndërhyrjes për të gjithë nën zërat me prioritetet e vendit tonë në kuadër të procesit të ri-integrimit të shtetasve të riatdhesuar.

⁷¹U mbështet tek udhëzuesit për punonjësit e administratës publike dhe strukturave shtetërore rreth mbështetjes rehabilituese dhe ri-integruese (R & R) për personat që kthehen nga zonat e konfliktit, hartuar në kuadër të programit.



Workshop përmbyllës i: “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet zërave lokalë dhe iniciativën lokale në BP” Link:<https://cve.gov.al/workshop-ne-permbyllje-te-projektit-parandalimi-i-ekstremizmit-te-dhunshem-ne-permjet-zerave-lokale-dhe-iniciativen-lokale-ne-ballkanin-perendimor/>

Bashkëpunimi me OSHC-të përfshin angazhimin e institucionit në realizimin e studimit⁷²

që kryhet nga IDM në kuadër të projektit “Ri-integrim i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, mbi identifikimin e potencialit për ekstremizëm të dhunshëm dhe faktorët mundësues lokalë në 4 qarqe, me fokus në Postrribë, Himarë, Dropull dhe Prespë, si dhe në zonat përreth tyre.

Prioriteti i QKEDH-së është nxitja e këtij bashkëpunimi për të qenë sa më efikas në fushën e çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm, i cili gjatë këtij viti u nxit edhe me kërkesën nga ana e Partners Albania të cilët i kërkuan QKEDH-së bashkëpunim në kuadër të financimit të Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) që do të zhvillojë një metodologji mbi vlerësimin e riskut për financimin e terrorizmit të OSHC-ve në Shqipëri.

⁷²QKEDH dhe IDM janë dakordësuar që grupi hulumtues i punës në IDM të ndërtojë instrumente që synojnë matjen e nivelit të prirjes për VERLT, si dhe të studiohet qëndrueshmëria e komuniteteve dhe gatishmëria e tyre për mirëprirjen e të kthyerve nga zonat e konflikteve. Projekti mbështetet financiarisht nga GCERF.

Bashkëpunimi me Kreun e Kreun e Këshillit Ndërfetar Shqiptar

Gjatë vitit 2021, Drejtori i QKEDH ka vijuar punën mbi bashkëpunimin e ndërsjellë për parandalimin e fenomenit me Këshillit Ndërfetar në Vend me të cilin institucioni ynë ka një bashkëpunim të frytshëm. Znj Dervishi ka organizuar dhe marrë pjesë në takime dhe aktivitetet e zhvilluara mbi ecurinë e angazhimit dhe të iniciativave të përbashkëta institucionale në kuadër të parandalimit të fenomenit dhe të P/KEDH.

Bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)

Prezantimi i parë i regjistrit kombëtar të përmbajtjeve joligjore online në kuadër të tryezës së punës “Forcimi i bashkëpunimi midis agjencive shtetërore dhe platformave online” është një prej bashkëpunimeve më domethënëse të misionit që kryen QEKDH në kuadër të bashkëpunimit institucional në nivel kombëtar. Fuqizimi i këtij bashkëpunimi ka ardhur duke rritur. Ai kulmoi me “Prezantimin⁷³ e portalit unik për sinjalizimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme” që synon mbrojtjen e fëmijëve nga këto Webfaqeve me përmbajtje të paligjshme duke përfshirë rastet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit online.

⁷³Aktiviteti u organizua nga Akademinë e Studimeve Politike, AKCESK dhe QEKDH. Morën pjesë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe të shkollave që funksionojnë si qendra komunitare, të cilat kanë eksperiencë në trajtimin e çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm.. Aktiviteti u pasqyrua mediatikisht edhe tek media “Zëri i Amerikës”; <https://www.zeriamerikes.com/a/5931219.html>

Partneriteti me donatorët dhe mbështetësit e Qendrës QKEDH

Ashtu si vitin e kaluar, QKEDH ka organizuar takimin⁷⁴ konsultativ me Donatorët me fokus monitorimin dhe vlerësimin e progresit të Shqipërisë në të gjitha politikat sektoriale ku u theksua përkushtimi i QKEDH-së në forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit në bashkëpunim me komunitetin e donatorëve për të progresuar sigurinë, rendin dhe luftën kundër kriminalitetit.

Që në fillim të këtij viti, me kërkesë të QKEDH-së u koordinua puna për grumbullimin e informacionit nga ana e katër organizatave implementuese të projekteve në zbatim, si IOM, TdH, LKGV si dhe IDM, në kuadër të konsorciumeve⁷⁵ përfituese shqiptare. Projektet në fjalë iu përcollën Zyrës së Kryeministrit. Implementimi i tyre është për parandalimin e fenomenit, si dhe rehabilitimi dhe ri-integrimi i LHT-ve dhe familjarëve të tyre, përmes mbështetjes me fonde nga donatorë të ndryshëm si GCERF⁷⁶ Departamenti i Shtetit, Zyra e kundër Terrorizmit e SHBA-ve, Qeveria e Holandës dhe Bashkimi Evropian.

Qeveria e Shqipërisë synon rezultate afatgjata dhe të qëndrueshme drejt procesit të Rehabilitimit dhe Ri integritetit të të kthyerve dhe familjeve të tyre. QKEDH vazhdon misionin e saj koordinues brenda një kornize të qasjes së përfshirjes së të gjithë shoqërisë - institucioneve publike, donatorët dhe partnerët mbështetës- për tri vitet e ardhshme, pa përjashtuar programet e parandalimit të fenomenit.

⁷⁴Takimi u zhvillua gjatë muajit nëntor.

⁷⁵Linja e Këshillimit të Gra dhe Vajza dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim janë fituese të konsorciumeve pas hapjes së thirrjes së GCERF-it për implementim në fushën P/KEDH.

⁷⁶Për më shumë informacion shih <https://www.gcerf.org/>.

Partneriteti me organizatën ndërkombëtare Angazhimi i Komunitetit Global dhe Fondi i Qëndrueshmërisë (GCERF)

Bashkëpunimi⁷⁷ i krijuar midis QKEDH me partnerin GCERF ka ardhur duke u intensifikuar. QKEDH ka mbajtur kontakt të vazhdueshëm me këtë partner dhe donator të rëndësishëm në zbatimin e planit të ri-integrimit duke ndjekur dhe monitoruar të gjithë procesin që po zhvillohet në bashkëpunim me OSHC-të të mbështetura financiarisht nga GCERF.

Pas marrjes pjesë në konferencën online “Komuniteti i 5-të Global i Praktikës Gratë, Burrat dhe Agjencitë e Komunitetit” u punua për realizimin e një dokumenti politikash për riatdhesimin e luftëtarëve të huaj në nivel rajonal, Ballkani Perëndimor. Në vijim u zhvillua takimi me partnerët fitues të dy Konsorciumeve të mbështetura nga thirrja e GCERF mbi përcaktimin e modaliteteve në zbatimin e projekteve të miratuara, në përputhje me prioritetet dhe nevojat e Qendrës CVE dhe institucioneve të linjës.

Organizimi i workshopit “Vlerësimi i riskut dhe zbutja e tij” është tjetër moment i bashkëpunimit me këtë partner. Aktiviteti⁷⁸ synoi të sigurote që përfituesit e granteve të fitonin njohuri mbi kuptimin e vlerësimit dhe të zbutjes së rrezikut në kontekstin e projekteve të tyre jo vetëm në projektet e financuara nga GCERF, i cili organizoi edhe raundin e dytë të Panelit Rajonal të Financimit të Përshpejtuar (PRFP), me fokus thirrjet e interesit të shprehura lidhur me fazën e dytë të dhënies së granteve në Ballkanin Perëndimor. Bashkëpunimi i QKEDH-së me GCERF është një partneritet strategjik në kuadër të realizimit të misionit që ka institucioni.

⁷⁷QKEDH në rolin e institucionit shtetëror përfaqësues, u pranua në maj 2020 për t'u bërë pjesë e shteteve përfituese përmes skemës së financimit të organizatave jo-qeveritare për të lëvruar fonde në kuadër të programeve specifike me natyrë rehabilituese, ri-integruese dhe parandaluese të Luftëtarëve të Huaj Terroristë dhe familjarëve të tyre duke pasjellë edhe rezultate specifike në drejtim të angazhimit të kësaj organizate me vendin tonë.

⁷⁸Morën pjesë organizatat jo-fitimprurëse nga Shqipëria, Kosova, si dhe Maqedonia e Veriut, të cilat kanë fituar thirrjen e hapur nga GCERF për financimin e projekteve të tyre.

Partneriteti me Zyrën Ndërkombëtare për Migracion në Shqipëri (IOM)

Për shkak të dinamikës së gjerë të bashkëpunimit, marrëdhënia ndër-institucionale me IOM⁷⁹, si një nga partnerët strategjikë më të afërt të QKEDH-së është shumë e rëndësishme për institucionin tonë. Projektet⁸⁰ që po zbaton IOM kontribuojnë në nivel kombëtar dhe rajonal në fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve qendrore dhe lokale me qëllim që t'u përgjigjen sfidave që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe të kthyerit nga zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme.

Në kuadrin e këtij bashkëpunimi evidentohen diskutimi me menaxherin e programit rajonal të IOM-it mbi projektet në vazhdim; me Koordinatorin Nën-rajonal të IOM UN të prioritetëve të Qeverisë Shqiptare mbi fenomenin, sfidat dhe nevojat e QKEDH-së në kuadër të koordinimit ndër-institucional të institucioneve të linjës në lidhje me programet Rehabilitim/Ri-integrimit për shtetasit e kthyer nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak. Bashkëpunimi me IOM ka konsistuar edhe në zhvillimin e trajnimeve⁸¹ për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të stafit të QKEDH-së.

⁷⁹IOM zbaton në vendin tone tre projekte: 1. "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes zërave lokalë dhe iniciativave në Ballkanin Perëndimor", mbështetur nga Departamenti Amerikan i Shtetit - Byroja Kundër Terrorizmit; 2. "Mbështetja e qeverive të Ballkanit Perëndimor në parandalimin dhe reagimin ndaj sfidave që lidhen me ekstremizmit të dhunshëm dhe të kthyerit nga zonat e konfliktit" mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme Holandeze; 3. Mbështetja e kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor për t'u marrë me sfidat që lidhen me ri integrimin, risocializim dhe rehabilitimin e kthimit luftëtarëve të huaj terroristë (RFTF) dhe familjet e tyre nga zonat e konfliktit", mbështetur nga BE.


⁸⁰Dy fusha të angazhimit të këtyre ndërhyrjeve janë: 1) komuniteti - në qendër; qasjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe 2) ndihma për lirimin dhe kthimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë (FTF) dhe familjet e tyre.

⁸¹QKEDH koordinoi me IOM realizimin e trajnimit "Mekanizmi i Granteve" që u zhvillua gjatë muajit Shtator 2021

2. ZBATIMI I PLANIT TË RI-INTEGRIMIT

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 148, datë 05.11.2019 “Për Miratimin e Planit Shtesë për Pritjen dhe Trajtimin e Shtetasve Shqiptarë që Kthehen nga Zonat e Konfliktit në Siri dhe Irak” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 26.10.2020 “Për Ofrimin e Shërbimeve për Pritjen dhe Akomodimin e Fëmijëve të Pashoqëruar të Kthyer nga Siria dhe Iraku”, QKEDH ka zhvilluar një aktivitet të gjerë për zbatimin e dy projekteve kombëtare të materializuara në një sërë veprimtarish konkrete, me bashkëpunime institucionale dhe me aktorë apo partnerë strategjikë, në fushat e zbatimit të tij.

Dy projektet i referohen ndërhyrjes⁸² që u realizua në bashkëpunim me Bashkinë Cërrik përmes procesit të parë rehabilitues dhe ri-integrues në komunitet për shtetasit e kthyer nga këto vende dhe familjet e tyre i cili përfundoi gjatë vitit 2021; si dhe programit⁸³ të dytë, ai i 24 (njëzetë e katër) shtetasve të riatdhesuar nga ish vendet e konfliktit Siri dhe Irak.



PROGRAMI NR. 1 – NDËRHYRJA NË BASHKINË CËRRIK

Viti 2021 shënoi përfundimin e programit⁸⁴ të parë rehabilitues dhe ri-integrues në komunitet, ndërhyrjen që u krye në Bashkinë Cërrik. Përmes implementimit të këtij programi që nisi në vitin 2020, në koordinim me pushtetin vendor u mbështeten dhe u trajtuan rreth 50 shtetas: burra (8), gra/vajza (7), fëmijë (35). Për secilin prej tyre u hartuan profile individuale dhe familjare përmes problematikave dhe cilësive specifike që prezantonin, të cilat shërbyen për dhënien e mbështetjes së konkretizuar.

Metodologjia që u aplikua në ndërhyrjen e zhvilluar në Bashkinë Cërrik



⁸²Programi i parë rehabilitues dhe ri-integrues në vend për personat e kthyer nga vendet e konfliktit dhe familjet e tyre nisi zbatimin në bashkinë Cërrik në maj të vitit 2020 dhe përfundoi në nëntor të 2021.

⁸³Më 27 tetor 2020, u riatdhesuan 5 personat e pare nga ish vendet e konfliktit, Siri dhe Irak. Më 1 Gusht 2021 u riatdhesuan 19 persona të tjerë, 14 prej tyre fëmije.

⁸⁴Ndërhyrja u mbështetet nga partnerët e Republikës së Shqipërisë, nga Departamenti i Shtetit të SH.B.A.-ve si dhe nga Mbretëria e Vendeve të Ulta, përmes implementimit nga organizata të shoqërisë civile, Zyra Ndërkombëtare për Migracion (IOM), si dhe Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social (IANS) dhe Qendra Fokus. Ndërhyrja u koordinua dhe implementua përmes strukturave në nivel bashkiak, Bashkia Cërrik.

Pas hartimit dhe miratimit të planeve ri-integruese familjare (janar 2021), ndërhyrja u fokusua në këto aspekte:

a) Mbështetje psiko-sociale individuale dhe familjare;

Gjatë vitit 2021, grupet e punës që përbëheshin nga stafi psiko-social i Bashkisë Cërrrik, stafi mbështetës profesionist nga implementuesi IANS kanë zhvilluar mbi 50 takime periodike në ofrimin e ndihmës psiko-sociale, seanca këshilluese dhe terapeutike si në format individual dhe atë në grup, me të gjithë përfituesit e ndërhyrjes.

b) Mbështetje me paketa ushqimore, higjieno-sanitare, veshmbathje për gjithë anëtarët e njësisë familjare;

Çdo muaj, njësitë familjare u mbështetën me paketë ushqimore, proces ky i koordinuar dhe lehtësuar nga QKEDH përmes dy partnerëve IOM dhe IANS. Për secilën njësi familjare, çmohet se vlera monetare mujore lëvizte brenda kufirit 5.000 – 10.000 ALL/muaj.

c) Mbështetje me medikamente sipas problematikave shëndetësore;

Në kuadër të situatës globale COVID-19, njësitë të caktuara familjare të gjendur në rast nevojë iu është mundësuar asistencë mjekësore mujore, përmes blerjes së mjekimeve ndaj këtij virusi.

d) Mbështetje me mjete didaktike për fëmijët në moshën shkollore;

Çdo muaj, njësitë të caktuara familjare të gjendur në rast nevojë, kryesisht atyre me të mitur në moshë shkollore, iu është mundësuar asistencë me mjete didaktike mësimore përmes blerjes së artikujve të ndryshëm shkollorë dhe argëtues.

e) Mbështetje me asistencë ligjore sipas rastit;

Njësitë e caktuara familjare të gjendur në rast nevojë janë mbështetur me asistencë ligjore. Në këtë qasje, vetëm 3 njësi familjare iu është ofruar këshillim juridiko-administrativ për çështje të caktuara, të cilat kanë rënduar situatën e të gjithë njësisë familjare.

f) Mbështetje për ngritjen e bizneseve familjare për tregtimin e rrobave të përdorura;

Pasi Bashkia Cërrrik shfaqti pranë QKEDH-së interesin e shprehur nga disa prej kryefamiljarëve të njësisë familjare mbi mundësinë për t'u angazhuar në një biznes privat, kryesisht atë të tregtimit të rrobave të përdorura, QKEDH ka advokuar, nxitur dhe mbështetur këto kërkesa. Si rrjedhojë, 3 kryefamiljarëve iu mundësua sigurimi i vendit të shitjes nga ana e Bashkisë Cërrrik, si dhe përmes IOM iu ble lënda e parë për nisjen e tregtisë. Lënda e parë iu dorëzua stafit bashkiak, i cili e ka ndjekur, lehtësuar dhe monitoruar këtë proces.

g) Mbështetje për ndërmjetësim për punësim në zonën ku banon ose me gjerë;

Gjithashtu, pas shfaqjes nga ana e Bashkisë Cërrik pranë QKEDH-së, së interesit të shprehur nga disa prej kryefamiljarëve të njërive familjare mbi interesin për t'u punësuar pranë një biznesi privat të ngritur në atë komunitet, u punua nga afër me Bashkinë Cërrik për të ndërmjetësuar takime me përfaqësues të biznesit lokal në mbështetje të këtyre kërkesave.

h) Mbështetje për referim në institucione të tjera në bazë të problematikave dhe specifikave të rastit etj.

Nën drejtimin e QKEDH-së dhe përmes koordinimit të punës ndër-institucionale me Bashkinë Cërrik, me Ministrinë e Linjës (në vijë të parë me MSHMC), procesi është një praktikë e mirë për ndërtimin e një sistemi ndërveprues si në nivel qendror, vendor dhe me palë të treta, ku përfituesit fundorë janë qytetarët shqiptarë.

Në muajin tetor 2021, QKEDH në bashkëpunim me IOM organizoi workshopin e përmbylljes së këtij projekti “Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet zërave lokalë dhe iniciativën lokale në Ballkanin Perëndimor”, gjatë cilit u prezantuan konkluzionet e zbatimit të këtij projekti.

PROGRAMI NR. 2

24 TË KTHYERIT NGA ZONAT E KONFLIKTIT, PESË TË KTHYERIT NË 27 TETOR 2020, 19 TË KTHYERIT NË 1 GUSHT 2021

Në zbatim të procesit rehabilitues dhe ri-integrues (R&R) të 24 (njëzetë e katër) shtetasve shqiptarë të riatdhesuar i cili përfshin procesin e ri-integrimit të 5 (pesë) shtetasve të rikthyer me 27 tetor 2020 dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve që u riatdhesuan me 1 gusht 2021⁸⁵, janë realizuar 102 (njëqind e dy) sesione informuese/takime, 13 (trembëdhjetë) trajnime në nivel vendor dhe qendror dhe 11 (njëmbëdhjetë) trajnime të ofruara për strukturat e përfshira drejtpërdrejtë në këtë proces.

⁸⁵ Link: <https://cve.gov.al/qendra-cve-angazhohet-ne-prijen-e-grupit-te-pare-te-qytetareve-te-riatdhesuar-nga-vendet-e-konfliktit/>

Në muajin shkurt 2021 përfunduan takimet informuese/ndërgjegjësuese⁸⁶ me stafin psiko-social të Bashkisë Tiranë që nisën në dhjetor të 2020, si dhe u realizua trajnim online mbi “*Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve*” ku morën pjesë punonjësit e QKEDH-së dhe të Qendrës Pritëse ku u akomoduan 24 (njëzet e katër) shtetasit e riatdhesuar nga vendet Siri dhe Irak.

Pesë shtetasit e riatdhesuar më 27 tetor 2020 qëndruan për një periudhë 4-mujore në Qendra Pritëse dhe dolën me 28.2.2021. Duke vlerësuar se përfshirja në proceset arsimore është një rrugë efektive në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integrimit të fëmijëve të kthyer nga Siria e Iraku, gjatë muajve prill-maj 2021 u zhvilluan disa takime koordinuese me edukatorin shtesë, i cili u planifikua t’u mundësohet dy të miturve të riatdhesuar në moshë për të ndjekur shkollën. Pas vlerësimeve paraprake dhe shprehjes së interesit për këtë detyrë, mbulimi i këtij pozicioni u plotësua nga i njëjti punonjës i cili ka qenë i angazhuar me të njëjtën detyrë pranë Qendrës Pritëse. Qëllimi i krijimit të këtij pozicioni pune mbështetës ishte fuqizimi i procesit të të nxënies të këtyre të miturve, për periudhën mars-gusht 2021 deri në rinisjen e vitit shkollor 2021-2022.

Ky proces është advokuar dhe lehtësuar nga QKEDH dhe po mbështetet nga partneri TdH , përmes fondeve të GCERF-it.

Nën orientimin e QKEDH, fokusi më i madh ka shkuar në adresim të mbështetjes së grave dhe fëmijëve, duke orientuar, drejtuar, lehtësuar punën e institucioneve përkatëse. Kjo mbështetje konsiston në identifikimin dhe ofrimin e një ambienti me qira⁸⁷, ofrimin e mbështetjes për ndërhyrjet kirurgjikale së bashku me fazën e rikuperimit pas ndërhyrjeve⁸⁸, sigurimin e përfitimit të KMCAP-së⁸⁹, sigurimin e procesit të aplikimit për dokument identifikimi të vlefshëm⁹⁰, sigurimin e nisjes së procedurave administrativo-gjyqësore për regjistrimin e të miturve me pashtetësi⁹¹, sigurimin e realizimit të procesit të vaksinimit të të miturve⁹², procesin e regjistrimit dhe vendosjes së të miturve në shkollë dhe çerdhe/kopsht⁹³, mbulimin e kostove për shpenzimet mujore, sigurimin dhe mundësimin e krijimit të kushteve me staf mbështetës rehabilitues për të miturit, si në qasjen psiko-sociale por dhe atë edukative dhe argëtuese⁹⁴.

⁸⁶Në total u realizuan 10 takime që synuan fuqizimin e aktorëve të vijës së parë, që do të angazhohen në proceset ri-integruese me shtetasit e riatdhesuar nga zonat e luftës në Siri dhe Irak apo dhe ato që priten në të ardhmen të cilat u zhvilluan gjatë periudhës Dhjetor 2020 – Shkurt 2021. Pjesëmarrja në këto takime ishte e limituar, 10 punonjës për çdo takim, në zbatim të masave të marra për shkak të Pandemisë COVID19.

QKEDH ka nxitur, koordinuar dhe realizuar pesë takime informuese dhe ndërgjegjësuere me familjarët e këtyre shtetasve të kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak. Këtë proces e ka drejtuar Drejtori i Qendrës Pritëse në koordinim me PMF-të respektive, të cilët në vijim të procesit kanë menaxhuar rastet pas vendosjes së tyre në komunitet.

Për sa i takon procesit të ri-integrimit për 19 (nëntëmbëdhjetë shtetasit) e riatdhesuar më 1 Gusht 2021, QKEDH koordinoi transportin e këtyre shtetasve nga Aeroporti i Rinasit drejt ambienteve të Qendrës Pritëse⁹⁵ në Durrës.

⁸⁷Advokimi i QKEDH-së mundësoi që donatori GCERF të dakordësojë dhe mbështetës Qeverinë Shqiptare përmes implementimit të projektit të parë, i cili u zbatua nga organizata Terres des Hommes “Reziliencë dhe Ri-integrimi i Sigurt për fëmijët dhe nënat që kthehen nga zonat e luftës”. Ky projekt lehtësoi dhe mbështeti nevojat primare si sigurim banese, pagesa të faturave mujore, ushqimore, mbështetje mjekësore dhe edukative, për periudhën e parë të vendosjes në komunitet për shtetasen F.R. dhe të miturit e saj.

⁸⁸Përmes koordinimit të QKEDH-së, MSHMS, Shërbimit Social Shtetëror, shtetasen F.R. iu mundësua nga strukturat shtetërore të kujdesit shëndetësor realizimi i ndërhyrjes kirurgjikale pranë Spitalit të Traumës në Tiranë, si dhe periudha rikuperuese pas ndërhyrjes, rehabilitimi fizioterapik dhe ndjekja në vijimësi për një rikuperim të plotë.

⁸⁹Përmes koordinimit të QKEDH-së, MSHMS si dhe Shërbimit Social Shtetëror, shtetasen F.R. iu mundësua nga strukturat shtetërore të kujdesit shoqëror, përfitimti i instrumentit mbështetës i Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë.

⁹⁰Përmes koordinimit dhe lehtësimit të QKEDH dhe Ministrisë së Brendshme/ Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë së Brendshme si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

⁹¹Përmes koordinimit dhe lehtësimit të QKEDH, MD-së dhe partnerit strategjik mbështetës UNICEF u identifikua partneri lokal nga organizatat e shoqërisë civile, i specializuar në fushën e regjistrimit të personave pa shtetësi, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS). Ky partner lokal, i referuar edhe nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka realizuar hapat ligjorë të parashikuar në legjislacionin për kërkesën e shtetasen F.R. paraqitur pranë gjykatës së rrethit Tiranë mbi regjistrimin e fëmijëve të mitur të lindur në Siri. Avokati i çështjes në trajtim u përcaktua Rudina Brari.

⁹²Përmes koordinimit të QKEDH-së dhe MSHMS u mundësua mbledhja e historikut mjekësor të shtetasve para largimit në drejtim të zonave të konfliktit si dhe regjistrimi i dy të miturve të lindur në Siri, me qëllim ofrimin e shërbimit mjekësor falas. U krye procesi i vaksinimit sipas protokollit kombëtar shqiptar të vaksinimit.

⁹³Përmes koordinimit të QKEDH-së dhe MAS për të kryer “Vlerësimin e dijeve” të të dy fëmijëve të mitur, përkatësisht të moshës 13 dhe 14 vjeç, me qëllim identifikimin e shkallës së njohurive të dijeve të tyre arsimore, u ngrit komisioni përkatës, sipas Udhëzimit nr.17, datë 09.05.2018, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë”. Në bazë të këtij vlerësimi më tej u procedua me identifikimin e shkollave më të përshtatshme, ku të miturit mund të ndiqnin programin mësimor si dhe njëherazi u hartuan dy planet individuale mësimore.

⁹⁴Këto shërbime shtesë janë jashtë skemës së ofrimit të shërbimeve nga ana e institucioneve shtetërore, si në nivel qendror dhe nga ai vendor. Ato janë ofruar nga palët e treta përmes zbatimeve të projekteve konkrete me fokus specifik në P/KEDH, të cilat vijnë si rezultat i punës koordinuese, advokuese, nxitëse të Qendrës CVE me donatorë kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë.

QKEDH e nisi punën koordinuese me institucionet e tjera që para mbërritjes së këtyre shtetasve në Shqipëri, duke përgatitur paketat humanitare⁹⁶ dhe përshtatur mjediset e Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve (SH.P.U) në Durrës për të shërbyer si Qendër Pritëse për këta shtetas. Njësitë familjare⁹⁷ që u transportuan drejt Qendrës Pritëse, të shoqëruar nga Drejtoria e Antiterrorit dhe Policia e Shtetit, u akomoduan në 4 (katër) dhomat e përgatitura më parë. **Qendra CVE⁹⁸ vendosi në dispozicion të këtyre shtetasve paketën humanitare⁹⁹ për 72 orët e para të procesit.** Si rrjedhojë e procesit koordinues të QKEDH-së që me datën 1 Gusht, në Qendrën Pritëse u vendos grupi i përbërë nga mjekë të MSHMS-së, punonjës socialë, psikologë dhe kujdestarë të cilët punuan me të kthyerit gjatë gjithë procesit të rehabilitimit të shtetasve të riatdhesuar. Gjithashtu, QKEDH u kujdes që punonjësit e Shërbimit Social Durrës dhe personat e tjerë të përfshirë në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të firmosnin Deklaratat e Konfidencialitetit.



Qeveria shqiptare përmbylli me sukses operacionin e tretë të riatdhesimit të 5 (pesë) grave dhe 14 (katërmëdhjetë) fëmijëve nga kampet e ferrit në Al-Hawl dhe Roj të Sirisë Veriore.

⁹⁶Procesi i përgatitjes dhe dorëzimit të paketave humanitare për të riatdhesuarit u realizua gjatë dy ditëve të fundit të muajit korrik (30-31 Korrik 2021) dhe u krye në varësi të grupimit të tyre sipas moshës dhe gjinisë. Paketat humanitare kishin në përbërjen e tyre 54 (pesëdhjetë e katër) artikuj të ndryshëm, të nevojshëm për higjienën dhe kujdesin bazik, duke nisur që nga sende të kujdesit personal, të higjienës, veshmbathje, atlete, lodra për fëmijë, lapsa dhe fletore vizatimi, biberonë, deri tek dezinfektuesit dhe doreza etj.

⁹⁷Iu nënshtruan kontrollit mjekësor i cili konsistoi në kryerjen e tamponit SARS-CoV-2 si dhe në realizimin e një kontrolli bazik shëndetësor.

⁹⁸QKEDH në bashkëpunim me institucionet e përfshira në proces dhe me organizatat ndërkombëtare në vend mundësoi që në dispozicion të shtetasve të riatdhesuar të vendosej e gjithë mbështetja logjistike dhe ekspertiza e nevojshme për pritjen dhe akomodimin e tyre. Qendra CVE diskutoi me partnerë/donatorë për sigurimin e ushqimit (catering) për një muaj qëndrimi në Qendrën Pritëse duke u siguruar që ushqimi i ofruar të ishte në përputhje me kriteret e nevojshme të sigurisë, si dhe në përshtatje me shtetasit e kthyer, një ushqim i përshtatshëm për besimtarë të fesë myslimane.

⁹⁹Në Qendrën Pritëse u bë ndarja e paketave humanitare nëpër dhoma, të cilat u dërguan nga Qendra CVE në Qendrën Pritëse një ditë para riatdhesimit në Rinas. Ndarja e tyre u bë në përputhje me numrin e personave që do të qëndronin në secilin dhomë, ndërsa u sigurua vendosja në punë e frigoriferit ftohës të ujit dhe dhomat të ishin të pajisura me ujë të rrjedhshëm dhe energji elektrike.

Përmes partnerëve UNICEF, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ) apo organizata të tjera, u realizua sigurimi i disa ndihmave shtesë higjeno-sanitare, rekreative ¹⁰⁰(lojëra) dhe nevoja specifike për veshjet, si dhe pajisje kompjuterike për punonjësit e Drejtorisë së Antiterrorit, me qëllim lehtësimin e procedurave të punës së tyre.

Me punën e saj koordinuese për mirë-organizimin dhe mirë-funksionimin e Qendrës Pritëse deri në muajin dhjetor kur doli edhe shtetasi i fundit i riadhesuar, QKEDH ka kryer monitorim të vazhdueshëm dhe ka qenë e pranishme për të asistuar në çdo nevojë të lindur gjatë procesit të rehabilitimit të të kthyerve të akomoduar atje.


QKEDH monitoroi mbylljen e Qendrës Pritëse në Durrës pas daljes dhe vendosjes në komunitet të të gjithë shtetasve të riadhesuar më 1 Gusht 2021, asistoi procesin administrativ të mbylljes së këtij institucioni i cili për një periudhë pesë mujore funksionoi për rehabilitimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë të riadhesuar, në kuadër të fazës së parë të procesit të Rehabilitimit, Ri-socializmit dhe Ri-integrimit (RRR).

QKEDH ka koordinuar, zhvilluar dhe monitoruar takimet e GTN-ve të ngritura për secilin rast ku janë shqyrtuar ecuria e rasteve dhe vlerësuar nevojat e tyre pas vendosjes në komunitet.

QKEDH ka koordinuar, ndihmuar dhe monitoruar procesin e vendosjes në komunitet të të këtyre shtetaseve së bashku me të miturit e tyre. Transferimi në banesat ku banojnë aktualisht u bazua në dëshirën dhe vullnetin e shprehur prej tyre. QKEDH ka qenë prezent në vendosjen e secilit rast në komunitet dhe ka koordinuar procesin e ecurisë së mëpasshme të tyre, me qëllim identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të shprehura prej këtyre shtetaseve duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët e përfshirë në proceset RRR. PMF-të përkatëse janë menaxherët e rasteve. Ata ndjekin nga afër procesin e ri-integrimit të secilit prej rasteve dhe koordinohen me QKEDH për funksionim sa më të eficient të procesit të ri-integrimit.

¹⁰⁰QKEDH përmes procesit koordinues lehtësoi procesin e krijimit të disa sallave rekreative që u realizuan nga organizata SHKEJ.

Lidhur me procesin e ri-integrimit në shkollë për fëmijët e rikthyer nga Siria në fazën e dytë (gusht 2021) është realizuar i njëjti proces koordinues i realizuar më fëmijët e riatdhesuar më tetor 2020.



Fillimisht u përcoll te MAS kërkesa zyrtare për vlerësimin e dijeve të fëmijëve të rikthyer, më pas udhëzimi¹⁰¹ Nr.10, datë 17.05.2021 i MAS u përcoll për tek aktorët e vijës së parë, e në vijim të procesit, QKEDH u angazhua në hartimin e një raporti përmbledhës mbi ri-integrimin e fëmijëve në shkollë dhe komunitet. QKEDH u angazhua në monitorimin e dy komisioneve të ngritura nga ZVA për vlerësimin e dijeve të 14 (katërmbëdhjetë) fëmijëve të rikthyer duke asistuar të gjithë procesin përmes monitorimit të metodave të përdorura nga profesionistët dhe përshtatjen e fëmijëve në proces. Në përfundim të tij, QKEDH-së iu përcollën raportet individuale së bashku me rekomandimet përkatëse për secilin fëmijë që kaloi në procesin e intervistimit.

¹⁰¹“Për regjistrimin e fëmijëve të personave në situatë migrimi/ azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë, viktime të trafikimit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim të zbatimit të ligjit¹⁰² 69/2012, në zbatim të Udhëzimit nr.10, datë 17.05.2021, referuar Udhëzimit nr.44, datë 21.08.2013, ZVA Tiranë, dhe pas ngritjes së komisionit të posaçëm nën koordinimin e QKEDH-së që vlerësoi dijet e fëmijëve të rikthyer prej zonave të konfliktit, nga 14 (katërbëdhjetë) fëmijë të cilët u prezantuan para komisionit të vlerësimit nga stafi i Qendrës Pritëse, 10 (dhjetë) prej tyre rezultuan në moshë shkollore.

Në vijim, përmes procesit komunikues dhe koordinues të QKEDH-së me MAS, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe të gjithë institucioneve të përfshira në proces, këta fëmijë janë regjistruar në shkollat pritëse dhe ndjekin procesin mësimor për vitin 2021-2022. Ecuria e tyre ndiqet nga PMF-ja përkatëse i cili raporton tek GTN- të të ngritura për rastet në kuadër të rehabilitim dhe ri-integrimit për këta shtetas, duke evidentuar problematikën e hasur dhe për t'i dhënë zgjidhje në bashkëpunim me përfaqësues të strukturave që janë pjesë e GTN.

3. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

QKEDH ka realizuar dhe marrë pjesë në një sërë procesesh raportuese në kuadër të raportimit institucional në kontekstin e marrëdhënieve ndër-institucionale të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe ato ndërkombëtare. **Institucioni ka shqyrtuar/ monitoruar/raportuar 122 (njëqind e njëzetë e dy) raportime në kuadër të zbatimit të P/KEDH dhe 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) raportime periodike mbi ecurinë e Procesit të Ri-integrimit të të riatdhesuarve nga vendet Siri dhe Irak dhe raporte vlerësimi për shtetasit e riatdhesuar.**

Në kuadër të përmbushjes së objektivit të monitorimit dhe raportimit, specifikojmë disa prej momenteve raportuese institucionale të cilat kanë shënjuar të gjithë veprimtarinë institucionale.

QKEDH ka përcjellë pranë Zyrës së Kabinetit të Kryeministrit të Republikës materialin e hartuar mbi zbatimin e projekteve të OSHC-ve të angazhuara në P/KEDH. Për sa iu përket ecurisë ndërhyrjeve të realizuara nga QKEDH, institucioni ka përcjellë pranë Këshilltarit për Sigurinë pranë Kryeministrit relacionin mbi ndërhyrjet e realizuara nga QKEDH dhe institucionet shtetërore që punojnë me P/KEDH në zonën Postribë, Bashkia Shkodër.


¹⁰² "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.17, datë 09.05.2018, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasë të arsimit bazë dhe për arsimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë".

Në kuadër të procesit të ri-integrimit që zhvillohet me shtetasit e riatdhesuar nga ish-vendet e konfliktit, QKEDH përgatiti një raport përmbledhës mbi procesin e rehabilitimit të 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve të riatdhesuar dhe e dorëzoi pranë Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH). Një dokument të tillë përshkrues të procesit të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak duke përfshirë edhe procesin e r rehabilitimit dhe ri integrimit, QKEDH e ka përcjellë edhe pranë MB-së.

QKEDH ka përfunduar dokumentimin¹⁰³ on-line të dosjeve individuale të pesë shtetasve që u riatdhesuan më tetor të 2020 dhe që janë përfshirë në proceset R&R ndërsa ka vijuar me plotësimin e dosjeve si në format fizik dhe në atë elektronik të shtetasve që u riatdhesuan më 1 Gusht 2021.

Në kuadër të kontributit të dytë për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021, dhe me kërkesë të MB-së, MD-së dhe MEPJ-së, institucioni ka kontribuar për kapitujt 23, 24, 31 dhe Kriterin Politik. Raportimi ka përfshirë periudhën prill - maj 2021 sipas metodologjisë së përcaktuar nga MEPJ. Ndërkohë që në muajin dhjetor të vitit 2021, QKEDH ka kontribuar pranë MB-së në kuadër të hartimit të PKIE 2022-2024 të Kapitullit 24 në vijim të matricës së KM të PAAP, ku rezulton e ndërlidhur me kapitullin 24 akti “Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2024” e cila është inkorporuar në variantin tabelar të PKIE. Kontribut është përcjellë edhe pranë MEPJ në kuadër të hartimit të PKIE 2022-2024, variant narrativ në shqip dhe anglisht, të Kapitullit 31 për angazhimin e institucionit në kundërshtimin e fenomenit.

¹⁰³ Arkivimi i dosjeve në formatin on-line është faza e dytë e krijimit të historikut të dosjeve individuale të përfshira në këto procese. Faza e parë konsistoi në arkivimin e dosjeve në format fizik. Procesi u koordinua nga QKEDH.



Një moment i rëndësishëm është raportimi që QKEDH realizoi përmes drejtuesit të saj në takimin online që u zhvillua më datën 23 nëntor 2021 në MB midis përfaqësuesve të Komisionit European (KE) dhe palës shqiptare ku u diskutua progresi i bërë në kuadër të implementimit të Planit të Përbashkët të Veprimit për Luftën Kundër Terrorizmit, mes BE-së dhe Vendeve të Ballkanit.

Raportimi përfshiu interesimin e palës përfaqësuese të KE –së në kuadër të ndërhyrjeve të realizuara nga institucioni ynë, prezantimi i punën së realizuar nga strukturat shtetërore në kuadër të procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit të shtetasve të rikthyer nga zonat e konfliktit në komunitet. Po pranë MB-së, QKEDH ka përcjellë dokumentin përshkrues të procesit të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, duke përfshirë edhe procesin e rehabilitimit dhe ri integrimit.

4. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV



Struktura Organike e QKEDH-së është miratuar me VKM nr. 737, datë 13.12.2017. Aktiviteti funksionon në përputhje me organigramën e cila ka në përbërje dy sektorë koordinimi: 1. Sektori i Koordinimit për Çështjet e Arsimit dhe Kërkimit dhe 2. Seksioni i Koordinimit për Shoqërinë Civile dhe Sigurinë. Aktiviteti drejtohet nga drejtori QKEDH-së.

Në kuadër të hartimit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2022, si dhe Urdhrin me nr. 19, date 5.11.2021 “Për miratimin e udhëzuesit të hartimit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve për vitin 2022”, QKEDH ka dërguar materialin final të PPAP-së lidhur me komentet e bëra nga departamenti i Njësisë së Programit të Akteve Rregullatore dhe RIA për kolonën N dhe L mbi përputhshmërinë e projekt-aktit me programin politik 2021-2025.

Në mbështetje të Urdhrit të Kryeministrit nr.148, datë 05.11.2019 “Për pritjen, rehabilitimin dhe ri integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak” dhe në VKM nr. 826, datë 20.10.2020, QKEDH ka hartuar kërkesat e Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022-2024, si dhe ka përcjellë Fishën e Politikave Prioritare pranë Departamentit të Mirëqeverisjes në Kryeministri.

QKEDH ka shpërndarë Protokollin Standard të Veprimit (PSV) pranë ministrive të linjës të përfshira në hartimin e PSV-së për procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit për dhënie vlerësimi mbi modalitetin e miratimit të Protokollit me qëllim që ky dokument të jetë i zbatueshëm për të gjithë institucionet e përfshira dhe profesionistët e vijës së parë të cilët mbartin detyrime nga ky proces.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe me qëllim plotësimin e parametrave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, QKEDH ka përshtatur ambientet e saj në përputhje me ruajtjen e informacionit të klasifikuar, bazuar në kriteret ligjore për këtë qëllim.


5. PRIORITETE 2022

Prioritete e QKEDH-së janë në vijim të procesit të realizuar gjatë vitit 2021. Institucioni vlerëson si prioritete absolute që presin zhvillimin e tyre gjatë aktivitetit të përditshëm: zbatimi i procesit rehabilitues dhe ri-integrues që po zhvillohet për shtetasit e riatdhesuarit dhe shtetasit që do të vijnë në të ardhmen; përfundimin e hartimit të Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit 2022-2026 si dhe zhvillimin e Komunikimit Strategjik si një prej sfidave me të rëndësishme në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2022-2026

Proceset RRR për shtetasit e kthyer dhe shtetasit të cilët mund të kthehen

Forcimi i bashkëpunimit me pushtetin lokal dhe OSHC.



Me urdhër të Kryeministrit Nr. 59, datë 1.04.2022, është miratuar Rregullorja e Brendshme e Institucionit të QKEDHS-së “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”.

DREJTOR
LEJDI DERVISHI

2021

Raporti Vjetor

<https://cve.gov.al>